



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.01.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, relator z. Ridvan Hado.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:45 dhe mbaroi në orën 17:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Emona Muçi*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Irena Plaku*** (anëtare)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
10. ***Markelian Koça*** (anëtar)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.*
- 7. BIRN.*
- 8. {...}, gjyqtar (në sallë).*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, relator z. Ridvan Hado.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e parë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për vitin 2024.

Kërkoj ndjesë për vonesën, por ishte për shkaqe objektive nga ana e Këshillit.

Siç jeni në dijeni, në rendin e ditës së sotëm kemi për shqyrtim 14 çështje dhe jo më larg se dje, kemi përfshirë edhe një nga çështjet që ka të bëjë me caktimin e një gjyqtari në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila ka karakter “urgjent” dhe prandaj e kemi përfshirë në rendin e ditës.

Atëherë, pa humbur kohë, nëse nuk kemi diskutime mbi përmbajtjen e rendit të ditës, unë do doja që të fillonim me shqyrtimin e çështjeve.

Çështja e parë ka të bëjë me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, ku relator është z. Hado.

(Zoti {...} është paraqitur në ambientet e Këshillit për t’u dëgjuar në seancë

lidhur me projektraportin e vlerësimit.)

Naureda Llagami: Atëherë, kërkojmë që të jetë prezent zoti {...}.

(Futet në sallën e mbledhjes gjyqtari z. {...}.)

Naureda Llagami: Përshëndetje z. {...}!

E para, kërkoj ndjesë për vonesën, por ishte për shkaqe objektive të Këshillit mbi rendin e ditës dhe renditjen e tij. Unë doja shkurtimisht t'ju thosha procedurën që ne ndjekim në këtë Këshill. Fillimisht fjala i jepet relatorit, i cili ka përgatitur projektraportin për ju, që është z. Hado, dhe më pas ju jepet fjala ju, që shkurtimisht duhet të parashtroni nëse keni gjëra të tjera përtej kundërshtimeve që keni depozituar, me të cilat të gjithë anëtarët e Këshillit janë vënë në dijeni.

Kështu që, pa humbur kohë, unë do doja që t'ia jepja fillimisht fjalën relatorit, dhe pasi ne përfundojmë këtë procedurë, ju do vazhdoni për të lejuar Këshillin që të marri vendim mbi miratimin e projektraportit tuaj. Kështu që zoti Hado, fjala për ju!

Ridvan Hado: Faleminderit!

Projektraporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarit z. {...}.

Procedura e vlerësimit ka filluar me vendimin nr. 81, datë 16.02.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pas dërgimit të dosjeve me aktet e vlerësimit profesional nga organet e rivlerësimit. Nga shorti jam përzgjedhur unë si vlerësues dhe nëpunësja përgjegjëse për vlerësimin znj. {...}.

Është njoftuar gjyqtari lidhur me fillimin e procedurës. Gjithashtu nuk ka pasur kundërshtime për vlerësuesin dhe nëpunësen përgjegjëse.

Pasi u gjet i plotë dokumentacioni i vlerësimit, u vijua me procedurën e vlerësimit.

Analiza e të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit është pasqyruar në mënyrë të plotë në projektraportin e vlerësimit, dhe për të mos u zgjatuar pasi të gjithë anëtarët

janë njohur me projektraportin e vlerësimit, vlerësoj të ndalem shkurtimisht tek konkluzionet e arritura për çdo kriter vlerësimi, dhe për treguesin e kundërshtuar nga gjyqtari do të ndalem në mënyrë më të detajuar.

Për kriterin e parë “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, treguesi 1.a.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave -

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, në tërësi, rezulton se gjyqtari ka aftësi “shumë të lartë” në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimin e normës konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e normave respektive në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes dhe për këtë arsye propozohet që të vlerësohet me 25 pikë.

1.a.b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes -

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit material dhe procedural në funksion të vlerësimit të çështjeve penale duke identifikuar në disa raste por duke zbatuar rregullisht praktikën gjyqësore unifikuese të gjykatës së lartë. Gjyqtari referon saktë dhe aplikon normën ligjore mbi faktet e çështjes, duke bërë zbërthimin e saj sipas elementëve të veprës penale, në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi faktet dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, si dhe duke zhvilluar analizën e veçantë të normave të ligjit, aty ku vlerësohet e nevojshme, për të nxjerrë në vijim konkluzionin në lidhje me përgjegjësinë penale të autorit dhe për këtë arsye propozohet që gjyqtari të vlerësohet me 25 pikë.

1.b.a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit -

Për këtë tregues, referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka aftësi të lartë në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Gjuha e thjeshtë dhe e kuptueshme e përdorur në arsyetim dhe mënyra e organizimit të mendimit, mundëson lexim të organizuar që ofron kalime nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra, në mënyrë logjike dhe për këtë arsye propozohet që gjyqtari të vlerësohet me 15 pikë.

1.b.b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit -

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme

dhe të mirëorganizuar të vendimit, e cila është e dukshme në aspektin vizual dhe të përmbajtjes, duke i dhënë qëndrueshmëri dhe kuptueshmëri vendimit. Ndjekja e një strukture të njëjtë, të mirëpërcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tyre dhe për këtë arsye propozohet që gjyqtari të vlerësohet me 10 pikë.

1.b.c. Cilësia e analizës dhe argumentit logjik -

Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik, përmbush në përgjithësi standardet e procesit të rregullt ligjor, si dhe jep përgjigje të argumentuar për pretendimet e palëve, duke mbështetur konkluzionin e gjyqtarit. Analiza e provave të marra në gjykim me qëllim evidentimin e faktit penal, i jep cilësi analizës dhe argumentimit logjik. E njëjta shkallë aftësie konstatohet edhe në aspektin e arsytimit të mënyrës se si ligji zbatohet mbi faktet e provuara dhe për këtë arsye propozohet që gjyqtari të vlerësohet me 25 pikë.

Në përfundim të këtij kriteri, niveli i vlerësimit për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarit” është "Shkëlqyeshëm" dhe pikët 100.

Kalojmë tek kriteri i dytë “Aftësia organizative e gjyqtarit” – kriteri i parë.

Duke iu referuar çështjeve të analizuara në të cilat nuk parashikohet ndonjë afat ligjor për përfundimin e tyre, aftësia e gjyqtarit në lidhje me këtë tregues duhet të pikëzohet në nivelin maksimal të tij dhe për këtë arsye propozohet që gjyqtari të vlerësohet me 15 pikë.

2.a.b. Plotësimi i standardeve minimale kohore -

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se numri i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor, është 9% (i papërfillshëm) dhe për këtë arsye propozohet që gjyqtari të vlerësohet me 5 pikë.

2.a.c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje -

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, për shumicën e kategorive të çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, ka qenë më e shkurtër se standardi minimal kohor. Në rastin kur rezulton vetëm një çështje jashtë afatit, me 24 ditë, ajo do të konsiderohet e papërfillshme, pasi dhe shkaqet e shtyrjes së

seancave janë për arsye objektive të palëve në proces. Në metodologjinë e pikëzimit parashikohet se për të bërë pikëzimin e këtij treguesi, të dhënat statistikore analizohen sipas situatës për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Referuar metodologjisë, duke qenë se për shumicën e kategorive të çështjeve, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është më e shkurtër se afati procedural, si dhe duke pasur parasysh volumin e ngarkesës që ka pasur, gjyqtari duhet të pikëzohet me 5 pikë.

2.a.ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore –

Për periudhën e vlerësimit rezulton se gjyqtarit i janë caktuar në total 1358 çështje dhe ka përfunduar me vendim 1100 çështje, pra norma e likuidimit të çështjeve është 81 %. Rendimenti në masën 81 % përkon me një pikëzim prej 4 (katër) pikësh.

Referuar metodologjisë së pikëzimit, për të vlerësuar këtë tregues, vlerësuesi nuk bën vetëm një veprim matematikor për të përcaktuar rendimentin e përfundimit të çështjeve, por ai bazohet edhe në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i nivelit të përqindjes. Në metodologjinë e pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: “të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal (100 çështje (krime dhe kundravajtje) të përcaktuar në standardin sasior të punës) të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.”. Bazuar në këtë parashikim dhe në analizën statistikore si më sipër, rezulton se gjyqtari ka tejkaluar standardin minimal të ngarkesës prandaj justifikohet një shkallë më e lartë pikëzimi prej 8 pikësh.

Pas komunikimit të raportit, gjyqtari ka depozituar parashtrime si më poshtë:

“Në lidhje me këtë tregues vërej se projektraporti i vlerësimit ka pasaktësi të dhënash në numrin e çështjeve gjyqësore të përfunduara dhe numrin e çështjeve gjyqësore të caktuara brenda një viti kalendarik (ndoshta për faktin se në numrin e

çështjeve të caktuara gjatë vitit kalendarik janë shtuar edhe ato të mbartura nga viti paraardhës) – që është një konkluzion i drejtë, - për të gjithë periudhën e vlerësimit 2013-2016, gjë që passjell edhe llogaritje të gabuar të rendimentit të përfundimit të çështjeve.

Kjo provohet referuar të dhënave të marra me shkresën nr. {...} prot., datë 03.11.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë bashkëlidhur statistikat përkatëse.

Për të gjithë periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtarit i janë caktuar në total 1193 çështje gjyqësore dhe ka përfunduar 1171 çështje, pra rendimenti i përfundimit të çështjeve është 98.2 %, ndërkohë që sipas projektraportit është 81%.

Sipas tabelave statistikore të gjykatës, në të paktën 2 vite periudhë vlerësimi, pretendon gjyqtari, është se kam gjykuar më shumë çështje se sa kam marrë (numri i vendimeve të shpallura është më i madh se sa çështjet regjistruara në një vit kalendarik). Fakti i mësipërm tregon se rendimenti im nuk është varur gjithmonë nga puna ime, por edhe nga faktorë jashtë vullnetit tim, për të cilët unë nuk kam shkak të mos vlerësohem maksimalisht.

Duke ditur problematikat, specifikën dhe ngarkesën në punë të gjyqtarëve të gjykatës Tiranë, faktin se të gjitha çështjet e përzgjedhura janë gjykuar brenda afateve procedurale, faktin se nga palët në proces apo drejtuesit e gjykatës në asnjë rast nuk ka pasur pretendime për zvarritje apo rendiment të ulët, si dhe rendimentin në masën 98.2 % kërkoj që edhe pikëzimi në këtë tregues të jetë ai maksimal prej 10 (dhjetë) pikësh.”

2.a.d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor -

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar rezulton “më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve” dhe për këtë arsye propozohet që gjyqtari të vlerësohet me 15 pikë.

2.b. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedurat gjyqësore -

2.b.a. Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive –

Referuar burimeve të vlerësimit, pavarësisht se numri mesatar i seancave

gjqësore është më i lartë se 3, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave joproductive dhe administrimin e procesit në tërësi është i lartë, prandaj gjyqtari duhet të vlerësohet me 15 pikë.

2.b.b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor -

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal, në seancat gjyqësore të zhvilluara dhe për këtë arsye propozohet që gjyqtari të vlerësohet me 20 pikë.

2.c. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore -

2.c.a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes -

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues dhe për këtë arsye propozohet që gjyqtari të vlerësohet me 5 pikë.

2.c.b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes -

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues dhe për këtë arsye propozohet që të vlerësohet me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive organizative të gjyqtarit” është "Shkëlqyeshëm" dhe pikët 98.

“Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” - 3.a. Etika në punë.

3.a.a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion -

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të etikës në punë dhe për këtë arsye propozohet që gjyqtari të vlerësohet me 35 pikë.

3.b. Integriteti i gjyqtarit –

3.b.a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti -

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të integritetit, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme, apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e tij dhe për këtë arsye propozohet që gjyqtari të vlerësohet me 40 pikë.

3.c Paanësia e gjyqtarit -

3.c.a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese -

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë dhe propozohet që pikëzohet me 10 pikë.

3.c.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit -

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit. Prandaj, për këtë tregues vlerësohet se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është i pakonsiderueshëm dhe propozohet që të vlerësohet me 15 pikë.

Në përfundim niveli i vlerësimit për kriterin e tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” është "Shkëlqyeshëm" dhe pikët 100.

Kriteri i katërt “Aftësia personale dhe angazhimi profesional”, 4.a Aftësia e komunikimit -

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve dhe për këtë arsye propozohet që të vlerësohet me 25 pikë.

4.a.b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale -

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale

dhe për rrjedhojë, presumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit dhe për këtë arsye propozohet që të vlerësohet me 15 pikë.

4.b. Aftësia për të bashkëpunuar -

4.b.a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, presumohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta dhe propozohet që gjyqtari të vlerësohet me 15 pikë.

4.b.b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore -

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, presumohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta dhe për këtë arsye propozohet që gjyqtari të vlerësohet me 10 pikë.

4.c. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.c.a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale -

Referuar të dhënave, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës penale, gjithsej 5 aktivitete të zhvilluara për 18 ditë, kohëzgjatje e cilave është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën trevjeçare dhe për këtë arsye propozohet që të vlerësohet me 20 pikë.

4.c.b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve –

Referuar të dhënave rezulton se për këtë tregues, gjyqtari të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si ekspert dhe për këtë arsye propozohet që të vlerësohet me 5 pikë.

4.c.c. Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata -

Referuar burimeve të vlerësimit, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtarit, nuk rezulton që gjyqtari për periudhën e vlerësimit 2013-2016 të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë apo veprimtari të tjera, të tilla si: pjesëmarrje në konferenca shkencore mësimdhënie, fjalime publike, pjesëmarrja në aktivitete të edukimit të komunitetit, kontribute për hartimin dhe ndryshimin e legjislacionit etj.

Duke iu referuar metodologjisë së pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët e fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, Vlerësohet se për gjyqtarin {...} ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera.

Pas komunikimit të raportit, gjyqtari ka parashtruar pretendimet e mëposhtme:

“.. kërkoj të sjell në vëmendjen tuaj faktin se gjatë periudhës objekt vlerësimi kam pasur një pjesëmarrje aktive, duke u angazhuar dhe dhënë kontributin tim profesional si në takime konsultative, tryeza dhe diskutime profesionale midis kolegësh, aktorësh shqiptarë dhe të huaj dhe specialistëve të fushës, në kuadër të iniciativave apo diskutimeve me qëllim përmirësimin e legjislacionit penal, procedural penal, si dhe projekteve të hartuara në procesin e reformës në drejtësi.

Kontributi i dhënë në veprimtaritë e zhvilluara të evidentuara sa më sipër është konfirmuar edhe me shkresën nr. {...} prot., datë 30.10.2023 të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Shqipërisë, në të cilin pasqyrohet pikërisht fakti i angazhimit ndërinstitucional dhe vërtetim nr. {...} prot., datë 02.11.2023 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë nr. {...} prot., datë 02.11.2023.

Veç sa më sipër, gjatë periudhës objekt vlerësimi, jam angazhuar në veprimtari mësimdhënie si pedagog i jashtëm i lëndës “e drejta penale” pranë Departamentit të Shkencave Juridike në “{...}”, fakti i cili provohet me vërtetimin nr. {...} prot., datë 03.11.2023, pagesat bankare, si dhe e-mail-in e datë 28.01.2014.

Vlerësoj të sjell në vëmendjen tuaj që gjatë periudhës objekt vlerësimi kam qenë anëtar i Komisionit të Etikës, Verifikimit të Mandateve dhe Përmirësimit të Vazhdueshëm Profesional, të Konferencës Gjyqësore Kombëtare (shiko vendimin nr. {...}, datë 13.12.2012 dhe vendimin nr. {...}, datë 14.12.2015 të konferencës gjyqësore).

Kontributi i dhënë në kuadër të veprimtarisë së këtij komisioni ka qenë i vazhdueshëm dhe duhet marrë në konsideratë edhe në këtë vlerësim.

Kam pritur dhe shoqëruar në Gjykatën e Rrethit gjyqësor Tiranë, grupe qytetarësh (kryesisht të rinj dhe nxënës shkollash në ditët e drejtësisë), kam marrë pjesë në takime pune apo shkëmbim informacionesh me përfaqësues të institucioneve të ndryshme (p.sh. Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar, projekte për menaxhimin e gjykatave, etj.), jam treguar aktiv në angazhimet e menaxhimit të gjykatës (për shkak edhe të përvojës si kryetar gjykate) sidomos në veprimtarinë që lidhet me funksionimin e Drejtorisë së Burgjeve, Policisë së Shtetit, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, etj .

Duke marrë parasysh sa më sipër, kërkoj që edhe pikëzimi në këtë tregues të jetë ai maksimal 5 (pesë) pikë.”

Metodologjia e pikëzimit për pikëzimin e këtij treguesi përcakton se do të konsiderohen veprimtari jashtë funksionit, të tilla si: fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdueshëm; angazhimi si ekspert në punët e këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshëm me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike. Duke marrë parasysh se pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët e fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë. Një ose dy pikë të tjera iu shtohen në vlerësim gjyqtarëve që kryejnë këto veprimtari njëkohësisht me veprimtarinë gjyqësore, duke marrë parasysh sasinë dhe cilësinë e angazhimit, shkallën e pjesëmarrjes së gjyqtarit, ndikimin në veprimtarinë specifike dhe shtrirjen ndërkombëtare të angazhimit, si dhe çdo e dhënë tjetër që del nga burimet e vlerësimit të këtij tregues.

Është vlerësuar me 3 pikë. Dhe pretendimi i gjyqtarit është që kërkon 5 pikë.

4.c.ç. Publikimet ligjore akademike -

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të ketë realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, nuk mund të vlerësohet për këtë tregues dhe për këtë arsye propozohet që gjyqtari të vlerësohet me 0 pikë.

Pas komunikimit të raportit, gjyqtari ka parashtruar pretendime si më poshtë:

“... jam një nga bashkautorët e botimit juridik me titull “Roli i prokurorit jashtë sistemit të drejtësisë penale”, botuar në Revistën Juridike “Botime të Këshillit të Evropës”, Strasburg, me ISBN 978-92-871-7670-7, në tetor 2013, nga Këshilli i Evropës, të cilin e gjeni bashkëlidhur.

Bashkautorësia në hartimin e këtij botimi si një prej 9 anëtarëve të grupit të ekspertëve nga të gjithë vendet anëtare të Këshillit të Evropës është mundësuar nëpërmjet konkurrimit dhe përzgjedhjes nga sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Evropës. Fakti i zgjedhjes time si specialist/ekspert provohet edhe me shkresat e Këshillit të Evropës si komunikimin e emërimit tim në grupin e specialistëve, komunikimet elektronike, pagesat e kryera nga Këshilli i Evropës, etj.

Duke marrë parasysh sa më sipër, kërkoj që edhe pikëzimi në këtë tregues të jetë ai maksimal prej 5 (pesë) pikësh”.

Për sa i përket pra nivelit të vlerësimit dhe pikëzimit për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional” është edhe kriteri i katërt, propozimi për nivelin e vlerësimit është "Shkëlqyeshëm" dhe pikët 93, ndërsa gjyqtari pretendon për të shkuar në 95.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi dhe nivelin e përgjithshëm të vlerësimit është:

Aftësitë profesionale të gjyqtarit, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Aftësitë organizative të gjyqtarit, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 98.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm" dhe pikët 93.

Vlerësimi i përgjithshëm me 391 pikë.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Hado!

Atëherë, fjalën ia jap z. {...}, lidhur me shkurtimisht nëse ka gjëra të tjera përveç atyre që ka parashtruar në Këshill.

{...}: Faleminderit, për mundësinë!

Besoj se zoti Hado ishte shumë korrekt, madje i citoi fjalë për fjalë të gjitha pretendimet e mia. Nuk vlerësoj t'ju marrë kohën tuaj. Nëse keni ndonjë pyetje, por në mënyrë të përmbledhur mund t'i them.

Momenti i vlerësimit të rendimentit, kam përshtypjen që duhet të jetë një lapsus në përllogaritjet, sepse në të paktën në dy vitet mua më bie të kem më shumë se 100% të raportit të çështjeve të marra për gjykim me ato të përfunduara. Besoj është çështje matematike.

Në lidhje me angazhimet në veprimtari ndërinstitucionale, mbase për shkak të përvojës por edhe moralisht unë e kam të vështirë që kudo ku kontribuoj të kërkoj vërtetim. Pasi u njoha me projektraportin, ju konstatoji qartësisht që kam kontribuar qoftë në ekzekutivin, qoftë në legjislativin, qoftë si anëtar i Komisionit të Etikës. Plus që ata që më njohin prej vitesh e dinë që mua nuk më mungon as angazhimi, as kuraja për të thënë mendimin dhe për të dhënë atë kontribut sado modest.

E diskutueshme mund të ngelet ose e paqartë angazhimi im në Këshillin e Evropës. Është shumë e thjeshtë. Jam përzgjedhur si ekspert të një nga botimet që duhet të bënte, në fakt ishte rezolutë e Këshillit të Evropës. Janë bërë më shumë se 30 ditë punë në të. Jam angazhuar më shumë se 5-6 herë. Produkti i kësaj pune është edhe botimi që ka bërë Këshilli i Evropës në tetor të vitit 2013. Vlerësoj që ky është një kontribut i cili duhet marrë parasysh. Atë e vlerësoni ju domethënë. Në qoftë se llogaritjet që të marrësh pjesë në një botim të Këshillit të Evropës, të japësh kontributin në hartimin e një rezolute

që ka të bëjë pikërisht me rolin e prokurorëve, që është brenda fushës time dhe trajnimeve të mia, vlerësoj që duhet të kihet parasysh nga ju.

Pse nuk janë pasqyruar në projektraport, besoj që është çështje përvoja, ndoshta çështje që kryesisht me sa kam kuptuar baza e të dhënave kanë qenë ato të marra nga procesi i rivlerësimit (prej vetting-ut). Të gjitha këto nuk ndikonin në procesin e rivlerësimit dhe për këtë arsye nuk e kam parë të arsyeshme që duhet t'ia bëja me dije gjatë atij procesi.

Në vijim, zoti Hado i pasqyroi qartësisht, kështu që nuk është se kam diçka tjetër.

Naureda Llagami: Shumë faleminderit!

Nga kolegët nëse ka ndonjë pyetje për saktësi ose sqarim, meqë e kemi magjistratin këtu?

(Nuk ka pyetje.)

Zoti {...}, shumë faleminderit!

Mund të vazhdoni!

Edhe një herë ndjesë për vonesën e papërshtatshme.

Ju mund të vazhdoni, sepse Këshilli vijon diskutimet dhe merr vendimin, gjë që ju komunikohet juve direkt.

Faleminderit!

(Largohet nga salla e mbledhjes gjyqtari z. {...}.)

Naureda Llagami: Atëherë, fjalën ia japim fillimisht z. Hado çfarë qëndrimi keni lidhur me kundërshtimet.

Ridvan Hado: Lidhur me kundërshtimet e gjyqtarit {...}, për sa i përket kriterit të dytë, treguesit A.ç. “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore”, është i vërtetë pretendimi i tij. Statistikat e ardhura nga gjykata (fola edhe me nëpunësin vlerësues), Gjykata e Tiranës i bashkon... Metodologjia thotë që çështjet që vihen nga data 1 janar deri në 31 dhjetor. Ato kanë futur bashkërisht edhe të mbarturat, dhe në këtë kontekst

prandaj ka dalë përqindja më e ulur. Mbasi i bëra krahasimet, i pashë, pretendimi i tij është i drejtë. Në këto kushte i propozoj mbledhjes plenare që vlerësimi për këtë pikë, pra “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore”, nga 8 pikë, t’i bëhet 10 pikë.

Po ashtu, lidhur me pretendimin tjetër për “kontributet ndërinstitucionale”, nga 3 pikë jam i mendimit që ka dhënë mësim (nuk është e qartë fjala e zotit Hado)... dhe ai pretendimi që ngre për pikën e fundit për “Publikimet ligjore akademike” duhet të interferojë këtu, sepse ka qenë ekspert. Nuk rezulton që ta ketë emrin si botues. Botimi është në emër të Këshillit të Evropës. Nuk është as botim shkencor por e zëmë, s’e ka emrin fare.

Ndërkohë propozoj pra që edhe në kriterin e katërt, (*treguesi*) “Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykatë”, nga 3 pikë të vlerësohet me 5 pikë, duke u vlerësuar në përfundim në total me 395 pikë, duke ndryshuar pra kriteri i dytë nga 98 pikë, shkon 100 pikë dhe kriteri i “Aftësive profesionale”, kriteri i katërt, nga 93 pikë, në 95.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, faleminderit!

Përpara se ta hedhim në votim, kemi ndonjë...

Po, Irena!

Irena Plaku: Unë vetëm doja të saktësoja.

Jam dakord me propozimet që bëri zoti Hado. Vetëm doja të saktësoja se për sa i përket vërtetimit të mësimdhënies, rezulton që ka dhënë mësim, por në fakt i përket vitit shkollor 2012-2013, që përfundon në qershor. Kështu që nuk mund të konsiderohet kjo si veprimtari. Ai ka veprimtari ndërinstitucionale për shkak se ka kontribut për reformën në drejtësi. Edhe këtë si ekspert që ka dhënë kontributin për rezolutën e Këshillit të Evropës, por nuk mund të konsiderohet publikim. Vetëm këtë doja të saktësoja.

Gjithashtu doja të saktësoja edhe një gjë tjetër. Ka sjellë disa pjesëmarrje në disa komisione. Ato janë komisione të zgjedhura, detyrë që ai e ka ushtruar për shkak të

qenies gjyqtar dhe jo që ka një kontribut si veprimtari ndërinstitucionale. Po e saktësoj këtë, sepse mund të vijmë gjyqtarë të tjerë dhe të sjellim këtë dhe të thonë që e keni vlerësuar në këtë situatë. Prandaj doja ta saktësoja. Për mua është ky mendim, gjithsesi. Ai ka veprimtari, sepse ka dy gjëra të tjera që futen tek veprimtaria ndërinstitucionale.

Alban Toro: Në vijim të asaj që tha edhe Irena.

Në lidhje me vërtetimin për indikatorin e veprimtarisë jashtë institucionale ku është paraqitur një vërtetim dhe një e-mail përkatësisht nga shkolla "{...}", ku provohet që ky ka dhënë mësim, ndërkohë që ky vërtetim, është i datës 03.11.2023 dhe jep vërtetim dhe konfirmon faktin e mësimdhënies për nëntor-dhjetor 2013, ndërkohë që e-maili i 2014 nuk provohet, është një shtetase e quajtur {...} e cila fton për të korrigjuar disa teza, por që në fakt nuk rezulton e provuar që - bie nga një e-mail privat - dhe nuk rezulton e provuar që ky e-mail apo kjo shtetase t'i përkasë punëmarrësit apo punëdhënësit të "{...}". Kështu që në këtë kuadër, teorikisht duhet të kishte ky akt, kjo provë shkresore, duhet të kishte bashkëngjitur edhe faktin e marrëdhënies së punës midis Dhuratës dhe universitetit përkatës. Sepse në kushtet e tilla është thjesht një deklarament privat i bërë nga një e-mail privat, për ca fakte që nuk e dimë nëse parkojnë me të vërtetë me mësimdhënie apo jo. Kështu që mendoj që mos të merret në konsideratë ky aspekt.

Naureda Llagami: Atëherë, hedhim në votim, duke qenë se relatori e pranoi vetë, rritjen e pikëve tek komponenti i rendimentit, nga 8 në 10 pikë. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

(Miratohet propozimi.)

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë tek propozimi tjetër që po vetë relatori e pranoi, por që kemi një propozim të ndryshëm nga zoti Toro, i cili është me qëndrimin që ka relatori në propozim. Kështu që nga 3 pikë në 5 pikë propozon vetë relatori për sa i përket pjesës së veprimtarisë dhe angazhimeve jashtë funksionit. Kështu që, jemi dakord me propozimin e relatorit?

(Kuvendi dhe Këshilli i Evropës – për këto dy materiale)

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

(Miratohet propozimi me shumicë votash.)

Naureda Llagami: Miratohet rritja e pikëve.

Atëherë, e hedhim në total në tërësi, që është niveli "Shkëlqyeshëm" dhe pikët janë 396, (korrigjohet) 395. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Pjesërisht dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi për gjyqtarin {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, me nivel të përgjithshëm vlerësimi "Shkëlqyeshëm" dhe 395 pikë.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.01.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

1. Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarit {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;
2. Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;
3. Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;
4. Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;
5. Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;
6. Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;
7. Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarit {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme. (Shtyrë nga mbledhja 07.12.2023).¹

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 13-ta sipas rendit të ditës.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:45 dhe mbaroi në orën 17:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami (kryetare)*
- 2. Ilir Rusi (zëvendëskryetar)*
- 3. Klodian Kurushi (anëtar)*
- 4. Fatmira Luli (anëtare)*
- 5. Emona Muçi (anëtare)*
- 6. Ridvan Hado (anëtar)*
- 7. Irena Plaku (anëtare)*
- 8. Alban Toro (anëtar)*
- 9. Gentiana Muçaj (anëtare)*
- 10. Markelian Koça (anëtar)*
- 11. Yllka Rupa (anëtare)*

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.*
- 7. BIRN.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës

(relator z. Alban Toro):

1. Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarit {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;
2. Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;
3. Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;
4. Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;
5. Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;
6. Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;
7. Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarit {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme. (Shtyrë nga mbledhja 07.12.2023.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër,.

Sikurse u dakordësuam edhe më parë. Projekt-akti tjetër ka të bëjë me fillimin e procedurave të transferimit për gjyqtarët të cilët për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatat ku janë, duhen caktuar në gjykata të tjera në mënyrë të përhershme. Ky është një akt në fakt që është shtyrë nga mbledhja e kaluar e Këshillit të Lartë Gjyqësor, kështu që jemi vënë në dijeni nga ana e relatorit. Atëherë, unë do të ftoja relatorin e projekt-aktit që është zoti Toro për të relatuar projekt-aktin .

Alban Toro: Faleminderit!

Atëherë, ashtu siç thatë edhe ju, e konfirmoj faktin që është një relacion i cili është përgatitur prej kohësh, por që për shkaqe objektive, aktualisht po relatohet në këto momente.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, referuar nenit 147 të Kushtetutës ka përgjegjësi jo

vetëm për të siguruar mbarëvajtjen dhe administrimin e pushtetit gjyqësor, por ka përgjegjësi për të siguruar pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e tij, kjo e fundit tregues i qartë i përgjegjësisë në fushën e statusit të gjyqtarëve. Më tej, Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve” e ka përcaktuar Këshillin e Lartë Gjyqësor si organin më të lartë përgjegjës për emërimin, caktimin në pozicion, transferimin, ngritjen në detyrë, komandimin dhe riemërimin, vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale si edhe garantimin e të gjitha të drejtave të njohura nga statusi i magjistratit. Në kohë të ndryshme dhe nëpërmjet aplikimit të sistemeve të masave të ndryshme ligjore, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka ndërhyrë në sistemin gjyqësor të Republikës së Shqipërisë me qëllim plotësimin e vakancave të krijuara si pasojë e zbatimit të Ligjit nr. 84/2016 si edhe normalizimit të ngarkesës së saj detyrim për më tepër i parashikuar nga neni 89 “b” i Ligjit 115/2016. Në vijim të përcaktimit të hartës gjyqësore miratuar me Vendimin nr. 495, datë 21.07.2022 të Këshillit të Ministrave nga ana e Këshillit filluan procedurat ligjore të lëvizjes paralele parashikuar nga neni 43 i Ligjit nr. 96/2016.

Më falni sepse pati një problem teknik.

Në vijim të përcaktimit të hartës gjyqësore miratuar me Vendimin nr. 495, datë 21.07.2022 të Këshillit të Ministrave nga ana e Këshillit filluan procedurat ligjore të lëvizjes paralele parashikuar nga neni 43 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve”.

Kjo procedurë filloi në disa Gjykata të konsideruara në nevojë për shkak të: i) numrit të madh të pozicioneve të përhershme; ii) pakësimit të trupës gjyqësore; iii) ngarkesës së konsiderueshme të konflikteve gjyqësore; iv) si edhe kohës së gjatë që kërkohet për përfundimin e tyre duke kompromentuar të drejtën e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, një ndër parimet më të rëndësishme të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, (KEDNJ), neni 6), të cilat aktualisht janë në përfundim e sipër.

Gjithashtu për shkak të përfundimit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve në konkurrencë për pozicionet e hapura nëpërmjet lëvizjes paralele nga ana e Këshillit u mundësua caktimi në funksionin e gjyqtarit të kandidatëve të cilët kishin mbaruar verifikimin dhe studimet në Shkollën e Magjistraturës (40 të tillë).

Edhe pas këtyre masave që synonin normalizimin e situatës nëpër juridiksione të

përgjithshme gjyqësore konstatohen pozicione të lira të përhershme të krijuara si pasojë e Vendimeve të Organeve të Rivlerësimit të cilat do të duhen plotësohen nëpërmjet të njëjtit mekanizëm ai i parashikuar nga neni 43 i Ligjit “Për Statusin”.

Në këtë kuadër për shkak të synimit të hapjes së lëvizjes paralele në disa gjykata të juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë dhe administrative duke synuar jo vetëm plotësimin e vendeve vakante, garantimin e karrierës së gjyqtareve, përfundimin e ristrukturimit të disa gjykatave si pasojë e zbatimit të hartës gjyqësore dhe në plotësim të detyrave të lëna nga Këshilli, më datë 14.06.2023, nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës është iniciuar procedura e transferimit të gjyqtareve për shkak të suprimimit të pozicioneve ku ata janë caktuar në mënyrë të përhershme. Ky detyrim është krijuar pasi Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të vlerësojë, periodikisht ose rast pas rasti, nevojën për plotësimin e vendeve të lira në gjykata duke respektuar kushtet dhe parimet të parashikuara në nenin 42 në përgjithësi lidhur me transferimin e magjistratit dhe në mënyrë të veçantë ato të parashikuara në pikën 3 të këtij neni.

Qëllimi i nenit 42 është të garantojë se procesi i transferimit të përkohshëm ose të përhershëm të magjistratit, në pozicione të ndryshme brenda të njëjtit nivel ose të barasvlershëm me të, të bëhet jo vetëm sipas nevojave të sistemit të drejtësisë, por edhe në respektim të funksionit të magjistratit. Duke vendosur disa parime bazë, mbi të cilat kryhet transferimi, ligjvënësi synon së pari të disiplinojë këshillat në vendimmarrjen që lidhen me transferimin në pozicione të përhershme ose të përkohshme të magjistratëve sipas rregullave të parashikuara specifikisht dhe procedurave respektive. Së dyti, ai synon të ofrojë siguri, qartësi dhe parashikueshmëri për magjistratin, i cili mund t’i nënshtrohet lëvizjes në pozicion.

Më tej, pika 3 përcakton rrethanat dhe kategoria e magjistratëve që caktohen në një pozicion të lirë të përhershëm, konkretisht:

- a) nga magjistrati që ka të drejtë të caktohet në nivel apeli;
 - b) nga magjistrati që transferohet për shkak të papajtueshmërisë ambientale ose për shkak të ndryshimeve në strukturën administrative ose kompetencën tokësore të gjykatave ose prokurorive. [...].
- a) magjistrati që ka të drejtë të caktohet në nivel apeli;

b) magjistrati që transferohet për shkak të papajtueshmërisë ambientale ose për shkak të ndryshimit të strukturës administrative; - i cili është edhe rasti konkret.

c) magjistrati që transferohet sipas lëvizjes paralele;

ç) magjistrati që ka të drejtën e ngritjes në detyrë (pika 3).

Për plotësimin e pozicioneve të lira të përhershme Këshilli është i detyruar të respektojë radhën sipas shkronjave të mësipërme a); b); c) dhe ç).

Në kushtet kur Gjykatat e sipërcituara janë gjykata të shkallës së parë për të cilat procedura e ngritjes në detyrë në to nuk mund të aplikohet, pozicionet e lira të përhershme mund të plotësohen si rregull vetëm nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele në rast se nuk ka magjistratë që duhet të transferohen pranë këtyre gjykatave sipas parashikimeve të shkronjave “a” dhe “b”. Pas verifikimeve të kryera, ka rezultuar se aktualisht, Këshilli nuk ka detyrimin ligjor për të transferuar gjyqtarë sipas pikës “a” dhe pjesërisht sipas “b”, në kushtet kur nuk rezulton të këtë gjyqtarë që “kanë të drejtë të caktohen në nivel apeli” apo “gjyqtarë që duhet të transferohen për shkak të papajtueshmërisë ambientale”, ndërsa, në vlerësimin e këtyre kategorive, Komisioni ka konstatuar se në gjykatat e tjera të të njëjtit nivel e së njëjtës lëndë, ka disa gjyqtarë pozicioni i të cilëve në strukturat e gjykatave ku ata janë caktuar në mënyrë të përhershme, është suprimuar. Këshilli ka detyrimin që para vijimit e procedurës së lëvizjes paralele për plotësimin e pozicioneve të lira të përhershme në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë, duhet t’ua ofrojë këto pozicione për të zgjedhur pikërisht këtyre gjyqtarëve.

Kjo e drejtë e gjyqtarëve, të cilët rezultojnë jashtë strukturës së trupës gjyqësore ku ata janë caktuar në mënyrë të përhershme, rrjedh nga nenet 138 dhe 145/1 të Kushtetutës, si edhe ndër të tjera edhe nga nenet 42 pika 3/b, 44/b, 57 pika 3, 4 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të cilët garantojnë dhe sanksionojnë pavarësinë e jashtme dhe të brendshme të pushtetit gjyqësor.

Pavarësia individuale, sigurohet ndër të tjera edhe nga procedurat e emërimit, të promovimit të gjyqtarëve, bazuar mbi kualifikimin profesional dhe integritetit personal si edhe të detyrimit të ruajtjes të vendit të punës në momentin që ata ushtrojnë një detyrë

tjetër (të komanduar) në favor të sistemit të Drejtësisë.

Kuptimi dhe rëndësia e sistemit të garancive që lidhen me statusin e gjyqtarit është analizuar edhe më parë nga jurisprudenca kushtetuese, duke theksuar në këtë rast rëndësinë që ka ky sistem në kuadër të pavarësisë së gjyqtarit. Garancitë e sanksionuara nga dispozitat Kushtetuese u njohin gjyqtarëve një trajtim specifik jo vetëm në pagë, por edhe në qëndrueshmërinë apo ruajtjen e pozicionit të funksionit apo elementë të tjera që burojnë nga ushtrimi i saj.

Në këtë kuadër ligji specifik nr. 96/2016, ka parashikuar transferimin e detyrueshëm për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku ata janë caktuar në mënyrë të përhershme. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj e ka trajtuar transferimin si një mjet të nevojshëm që mund të përdoret vetëm me pëlqimin e gjyqtarit ose për nevojat e riorganizimit të sistemit gjyqësor (për të cilin nuk është e domosdoshme marrja e pëlqimit të tij).

Nga aktet e administruara nga struktura e personelit pranë KLGJ-së, rezulton se për shkak të situatës se trashëguar nga e kaluara, zbatimit të hartës gjyqësore si edhe faktit që ata janë duke ushtruar funksionin e gjyqtarit në mënyrë efektive jo në pozicionin e përhershëm konstatohen dy grupe gjyqtarësh.

Në të parin rezultojnë të jenë ata që procedurat e lëvizjes paralele apo të ngritjes në detyrë kërkojnë kohë të konsiderueshme të përfundojnë duke kompromentuar parimin e palëvizshmërisë dhe në dytën grupi i gjyqtarëve për të cilin procedurat e lëvizjes se procedurës paralele apo ngritjes në detyrë është në prag të përfundimit brenda një afati të arsyeshëm. Me këtë të fundit do të kuptohet se menjëherë me mbarimin e vlerësimit etik-profesional të tyre, brenda një kohe shumë të shkurtër do të përfundojë pasiguria në aspekt të pozitës civile-juridike të subjekteve të së drejtës, gjyqtarit, të cilit për shkaqe objektive të organizimit të sistemit gjyqësor i është suprimuar vendi (neni 42 pika 3 germa “b” e Ligjit për Statusin). Kjo kërkesë shtrohet në interes të dyfishtë, të personave me të cilët ka të bëjë drejtpërdrejtë, si dhe në interes të sigurisë së përgjithshme juridike në drejtim të Gjykatës së caktuar me ligj.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat
Struktura Organizative 8 Gjyqtarë.

Organika në Fakt 10 Gjyqtarë.

Efektivisht 6 Gjyqtarë.

Znj. {...} gjyqtare e caktuar në mënyrë të përhershme në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, aktualisht e transferuar në mënyrë të përkohshme në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë me vendimin nr. 94, datë 06.03.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Znj. {...} ka aplikuar për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm pozicionet nr. 502/2022, 504/2022 dhe nr. 240/2023. Në këto pozicione ka disa kandidatë për të cilët ende nuk ka përfunduar vlerësimi etik-profesional, e për pasojë procesi i ngritjes në detyrë për këtë kandidatë zgjat në kohë.

Z. {...}, gjyqtar i transferuar pa pëlqim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar (ka qenë gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda). Këshilli me vendimin nr.18, datë 25.01.2021, ndër të tjera ka vendosur: "...2.Transferimin e gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, duke filluar nga data 19.01.2021 dhe deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj tij sipas Ligjit nr.84/2016. 3. Në rast të konfirmimit në detyrë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, gjyqtari z. {...} gëzon të drejtën të zgjedhë për t'u transferuar në çdo pozicion, që do të jetë i lirë në atë moment apo që pritet të bëhet i lirë brenda gjashtë muajve, në gjykatat e shkallës së parë me juridiksionin të përgjithshëm, sikurse një gjë të tillë magjistratit ia garanton neni 44, pika 2, shkronja "b", e Ligjit nr. 96/2016.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër

Struktura Organizative 7 Gjyqtarë

Organika në Fakt 8 Gjyqtarë

Efektivisht 7 Gjyqtarë

Z. {...} gjyqtar i caktuar në mënyrë të përhershme pranë Gjykatës e shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, aktualisht i transferuar në mënyrë të përkohshme pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me vendimin nr. 529, datë 16.10.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për z. {...}

procedura e lëvizjes paralele mund të konsiderohet në fazën e përfundimit të saj. (Me plotësimin e dosjes së vlerësimit pas trajtimit të ankesës së depozituar në ILD, vijon procedura e vlerësimit etik-profesional). Z. {...} është kandidat në procedurë lëvizje paralele për pozicionin nr. 249 në Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, si edhe në pozicionin nr. 24 Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Z. {...} gjendet në të njëjtën situatë si znj. {...} që do të trajtohet në vijim në Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

Gjykata e Shkallës së parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier

Struktura Organizative 21 Gjyqtarë

Organika në Fakt 24 Gjyqtarë

Efektivisht 14 Gjyqtarë

Duke mbajtur në konsideratë, qëndrimin e Këshillit në vendimin nr. 582, datë 18.10.2023 “Për shpalljen e pozicioneve të lira për të diplomuarit në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2022-2023 dhe të emëruar gjyqtarë më datë 12.10.2023”, rezultojnë në Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, këta gjyqtarë mbi strukturë:

Znj. {...} gjyqtare e caktuar në mënyrë të përhershme në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, aktualisht e komanduar nëpunëse në Njësinë e Vlerësimit Etik dhe Profesional në KLGJ me vendimin nr.153, datë 29.03.2023 deri më datë 11.04.2025.

Znj. {...} gjyqtare e caktuar në mënyrë të përhershme në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, aktualisht e komanduar këshilltare ligjore pranë Njësisë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme të Këshillit, me vendimin nr.253, datë 07.07.2022.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë

Struktura Organizative 7 gjyqtarë

Organika në Fakt 8 gjyqtarë

Efektivisht 4 gjyqtarë

Z. {...} gjyqtar i caktuar në mënyrë të përhershme në Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, aktualisht i transferuar në mënyrë të përkohshme pranë në Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me vendimin nr. 528, datë 11.10.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor deri në datë 16.10.2024. Për z. {...} procedura e lëvizjes paralele për pozicionin e hapur me vendimin nr.14, datë 18.01.2023 mund të konsiderohet në fazën e përfundimit të saj pasi me plotësimin e dosjes së vlerësimit pas trajtimit të ankesës së depozituar në ILD, vijon procedura e vlerësimit etik-profesional. Z. {...} është kandidat i vetëm në pozicionin nr. 14/2023 të lëvizjes paralele për në Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë

Struktura Organizative 15 gjyqtarë

Organika në Fakt 16 gjyqtarë

Efektivisht 12 gjyqtarë

Znj. {...} gjyqtare e caktuar në mënyrë të përhershme në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, transferuar në mënyrë të përkohshme pranë Gjykatës së Lartë komanduar në funksionin e ndihmësmagjistratit me vendimin nr. 33, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, aktualisht subjekt i përfitimit të lejes së shtatzënisë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore deri më 10 mars 2024. Për znj. {...} janë pothuajse në përfundim procedurat e renditjes për pozicionin e hapur me vendimin nr.19, datë 18.01.2023, pasi me vendimin nr. 589, datë 18.10.2023 të Këshillit është miratuar renditja për këtë pozicion dhe znj. {...} është renditur e para në këtë pozicion. Të azhurnuar, aktualisht është përgatitur edhe relacioni përkatës për transferimin e detyrueshëm pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kështu që, pothuajse është e përfunduar edhe procedura për gjyqtaren në fjalë.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës

Struktura Organizative 7 gjyqtarë

Organika në Fakt 8 gjyqtarë

Efektivisht 5 gjyqtarë

Znj. Enkelda {...} gjyqtare e caktuar në mënyrë të përhershme në Gjykatën e

Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, aktualisht e transferuar në mënyrë të përkohshme pranë Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me vendimin nr. 96, datë 06.03.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjykata e Shkallës së parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë

Struktura Organizative 7 gjyqtarë

Organika ne Fakt 8 gjyqtarë

Efektivisht 6 gjyqtarë

Znj. {...} gjyqtare e caktuar në mënyrë të përhershme në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, aktualisht e transferuar në mënyrë të përkohshme pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës me vendimin nr. 527, datë 11.10.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor deri me datë 16.10.2024. Për znj. {...} procedura e lëvizjes paralele mund te konsiderohet në fazën e përfundimit në një nga pozicionet e hapura me vendim nr. 24/2023 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ose nr. 252/2023 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, pasi konkurren së bashku me z. {...} në këto pozicione.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë

Struktura Organizative 16 gjyqtarë

Organika ne Fakt 17 gjyqtarë

Efektivisht 14 gjyqtarë

Znj. {...} gjyqtare e caktuar në mënyrë të përhershme në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, aktualisht e komanduar nëpunëse në Njësinë e Vlerësimit Etik dhe Profesional në KLGJ me vendimin nr. 81, datë 02.03.2022 deri më datë 02.03.2024.

Për znj. {...} procedura e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm mund të konsiderohet në konsiderohet në fazën e fillestare, pasi është ende në procedurë faza e fillimit të verifikimit të kriterëve formale të kandidimit, pra është një procedurë e cila zgjat në kohë.

Gjykata Administrative e Shkallës së parë Lushnjë

Struktura Organizative 9 gjyqtarë

Organika në Fakt 10 gjyqtarë

Efektivisht 7 gjyqtarë

Z. {...} gjyqtar i caktuar në mënyrë të përhershme në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, aktualisht i transferuar në mënyrë të përkohshme pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr.530, datë 11.10.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor deri me datë 16.10.2024. Për z. {...} procedura e lëvizjes paralele konsiderohet në fazën e fillestare, ndonëse ai konkurren i vetëm në pozicionin nr. 256/2023, procesi i verifikimit të kriterëve formale është ende në procedurë, dhe për të duhet të kryhen edhe dy raporte të vlerësimit etik dhe profesional.

Në kuptim të nenit 42 pika 2, që të procedohet në lidhje me transferimin në një pozicion të lirë të përhershëm, duhet të mos ketë magjistratë me të drejtën për t'u kthyer në atë pozicion. Aktualisht nuk rezulton të ketë të tillë.

Nga verifikimi i strukturave të Gjykatave të Shkallës së Parë rezulton se për shkak të pasojave të krijuara nga procedurat e rivlerësimit kalimtar të kryer nga Autoriteti Publik konform Ligjit nr. 84/2016 ka rezultuar se Gjykatat me një numër të konsiderueshme pozicionesh të tilla janë: Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

Në kushtet kur këto gjykata kanë:

1. një ngarkesë të konsiderueshme të çështjeve gjyqësore në gjykim për të cilën kërkohet ndërhyrje efektive në evadimin e tyre dhe për të cilat më pas do të procedohet edhe me hapjen e lëvizjes paralele;

2. kanë gjyqtarë të komanduar pranë tyre për një periudhë të caktuar kohe të cilët pas përfundimit do të duheshin të ktheheshin në pozicionin e tyre, (neni 53 dhe 57 i Ligjit për Statusin), pozicion të cilin për shkak të ristrukturimit apo të organizimit të burimeve të reja të trupës gjyqësore u janë suprimuar;

3. të sipërcituarit kanë në shqyrtim çështje gjyqësore për të cilat kërkohet respektimit i parimit të vazhdimësisë së gjykimit dhe për shkak të saj me të drejtën e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm;

4. faktit që këto gjykata kanë në përbërjen e tyre më së shumti individë që gëzojnë

kriteret për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm duke krijuar në këtë mënyrë në të ardhmen vakanca të reja me hapjen së afërmi të këtyre procedurave.

Për rrjedhojë Komisioni, i propozon Këshillit, bazuar në nenet 4 dhe 147/1/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 dhe 89 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenet 42/3B, 44, 53, pikat 6 dhe 7, si edhe në nenin 57, pikat 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, transferimin e gjyqtarëve që rezultojnë jashtë strukturave organizative të gjykatave ku kanë emërimin e përhershëm, duke i ofruar këtyre gjyqtarëve të drejtën e zgjedhjes midis pozicioneve të lira të përhershme pranë gjykatave të sipërcituara në përputhje me kriteret e kërkuara për to. Në to të bëjnë pjesë grupi i parë i gjyqtarëve për të cilët kërkohet një kohë relativisht shumë e madhe në përfundimin e procedurave të lëvizjes paralele apo të ngritjes në detyrë fakt që komprometon të drejtat e garantuara nga statusi i gjyqtarit.

Në këtë grup bëjnë pjesë gjyqtarët znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. Enkelda {...}, znj. {...} dhe z. {...}.

Në fillimin e procedurës së transferimit për gjyqtarët që aktualisht rezultojnë jashtë strukturës organizative të gjykatave ku janë të caktuar në mënyrë të përhershme dhe kërkimit për të ushtruar të drejtën e zgjedhjes për t’u transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme në gjykatat për të cilat gëzojnë kriteret e kërkuara nga pozicioni janë marrë në konsideratë nga Komisioni:

- Pesha specifike e ngarkesës së seksioneve të Gjykatave pritëse;
- Përvoja që gëzon gjyqtari në fushën specifike;
- Kriteret e kërkuara nga pozicioni i ofruar në Gjykatën Pritëse.

Në lidhje me kriterin e tretë të sipërcituar, për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë ato plotësohen vetëm znj. {...}. Kjo e fundit me cilësinë e të komanduarës për shkak të eksperiencës specifike të fituar në Këshillin e Lartë Gjyqësor në fushën administrative rezultojnë të këtë një përvojë të tillë. Neni 44 i Ligjit “Për Statusin” synon të vendosë standarde, kritere në lidhje me transferimin pa pëlqim të magistratëve në thelb të së cilit rezultojnë të jetë mos cenimi i standardit për mos

lëvizshmërinë e magjistratit, duke siguruar kështu pavarësinë dhe paanshmërinë e tij në detyrë. Në rastin konkret kur transferimi kryhet për shkak të suprimimit të pozicionit të magjistratit, në pikën 2 të këtij neni, parashikohen kritere të qarta ligjore për caktimin e magjistratit në një pozicionin tjetër. Koncretisht në këtë pikë parashikohet se:

a) magjistrati transferohet në strukturën e re të gjykatës që ka në kompetencë tokësore gjykatën pranë të cilës magjistrati ka ushtruar më parë funksionin dhe nëse kjo nuk është e mundur atëherë

b) magjistrati ka të drejtën të zgjedh për t'u transferuar në çdo pozicion të lirë apo që pritet të bëhet i lirë brenda 6 muajve nga momenti i shkurtimit të pozicionit në gjykatë ose prokurori të të njëjtit nivel të së njëjtës kompetencë lëndore.

Rezulton qartë se dispozita në fjalë, nuk ka për qëllim kufizimin e lirisë së zgjedhjes së magjistratit të interesuar, por garantimin e trajtimit të tij në mënyrë më të favorshme, duke ruajtur garancitë e transferimit të tij në përputhje me interesat e tij dhe drejtën për zhvillimin e karrierës së tij. Nga analiza e tekstit të dispozitës, rezulton krejt e qartë se qëllimi i saj, parë në harmomi dhe me dispozitat e tjera, është caktimi i një trajtimi garantues minimal, për parimin e transferimit dhe zhvillimin e karrierës, duke ruajtur minimalisht pozitën e magjistratit përpara transferimit dhe mos përkeqësimin e pozitës së tij të mëparshme. Nga kjo mund të kuptohet se dispozita në fjalë, nuk ndalon, kufizon apo cenon të drejtën e gjyqtarit për të zgjedhur, apo edhe të drejtën e Këshillit për të vendosur ndryshe, për sa kohë kjo pranohet nga ana e magjistratit të interesuar dhe përkon me fushën e tij të interesit për zhvillimin e karrierës. Nisur nga ky qëllim garantues dhe jo kufizues i dispozitës, nuk paraqitet asnjë pengesë nga ana e Këshillit të vendosë për transferimin e magjistratit të interesuar në një fushë tjetër apo pozicion tjetër të kërkuar apo të pranuar nga magjistrati i interesuar si më e favorshme për interesin e tij për zhvillimin e karrierës, sipas Nenit 49 të Kushtetutës – E drejta për punë të ligjshme të zgjedhur ose të pranuar vetë-, pasi dispozita vendos në garanci minimale e cila ka natyrë lejuese për një trajtim më të favorshëm për transferimin e magjistratit të interesuar në një fushë tjetër apo pozicion tjetër më pranë interesave të tij.

Duke iu kthyer rastit në shqyrtim rezulton se në kushtet kur gjyqtarja në kuptim të pikës 6 nenit 43 të Ligjit “Për Statusin” ka të paktën një vit përvojë në fushën

administrative, ka shprehur pëlqimin edhe më parë nëpërmjet kërkesës për konkurrim në këtë gjykatë për një pozicion të përhershme në këtë gjykatë si edhe në përputhje edhe me standardet e tjera të mbajtura nga ana e Komisionit do të procedohet duke dërguar dy kërkitime ku gjyqtarja do të duhet të ushtrojë të drejtën e zgjedhjes për t'u transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme në gjykatat e të njëjtit nivel e së njëjtës lëndë me pozicionin e mëparshëm si edhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Kjo formulë do të përmbushë në mënyrë të kënaqshme jo vetëm kriteret e pozicionit të përhershëm, por mbi të gjitha do të respektojë vullnetin e ligjit si edhe të magjistrates.

Ndërkohë për magjistratët znj. {...} dhe znj. {...}, Komisioni nuk propozon përfshirje në strukturat e gjykatave, pasi ato prej shumë vitesh nuk kanë qenë në përbërje të ndonjë gjykate dhe pas njohjes së statusit të tyre me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor janë subjekt i nenit 36 të Ligjit "Për Statusin".

Më konkretisht, znj. {...} është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Dibër me vendimin nr. {...}, datë 01.07.1994, të ish-KLD. Liruar nga detyra e gjyqtares mbi kërkesën e saj me vendimin nr. {...}, datë 19.03.2003, të ish-KLD-së dhe emëruar nga Ministri i Drejtësisë në detyrën e inspektore në Drejtorinë e Inspektimit të Gjyqësorit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Çështjeve të Drejtësisë, në Ministrinë e Drejtësisë.

Znj. {...} është liruar nga detyra e gjyqtarit sipas praktikës së atëhershme, për shkak të përcaktimit të legjislacionit të kohës mbi papajtueshmërinë e funksionit të gjyqtarit edhe me çdo funksion dhe veprimtari tjetër publike ose private, megjithëse vetë ligji i kohës, nga ana tjetër, ka pranuar mundësinë e pranimin të gjyqtarëve në shërbimin civil në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë apo dhe të inspektorit në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë (Ligji nr. 8811, datë 17.05.2001).

Lirimi i znj. {...} nga detyra e gjyqtarit është bërë për shkak të kalimit/emërimit në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, pikërisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Çështjeve të Drejtësisë, në Drejtorinë e Inspektimit, veprimtaria e të cilës konsistonte në inspektimin e gjykatave dhe të gjyqtarëve, sikurse dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Ligji nuk ka përcaktuar afat për shërbimin në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë. Znj. {...} është emëruar inspektore në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë me mandat 5-vjeçar, në përputhje me Ligjin nr. 8811/2001, me vendim të

organit kompetent të kohës, ish-KLD-së. Mandati 5-vjeçar i inspektorit të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për znj. {...} ka përfunduar më datë 15.09.2015, por pavarësisht kësaj, organi (ish-KLD-ja) ka lejuar në heshtje vijimin e ushtrimit.

Ligji i ka njohur të drejtën e riemërimit gjyqtar, me kërkesën e vetë, pa e kufizuar në kohë këtë të drejtë. Njohja e këtij statusi është njohur, me efekt prapaveprues, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 313 datë 19.12.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është deklaruar pasja e statusit të magistratit dhe është komanduar në detyrën e nëpunësit përgjegjës në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor ku dhe vijon aktualisht.

Ndërkohë me shkresën nr. {...}, datë 31.07.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i është kaluar për kompetencë Këshillit të Lartë Gjyqësor raporti i hetimit disiplinor iniciuar me shkresën {...} prot, datë 22.06.2017 i Kryeinspektores të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë ku është propozuar “shkarkim nga detyra” për të. Kjo procedurë vijon të jetë e hapur, tashmë pranë Komisionit të Disiplinës dhe për të nuk ka një vendim përfundimtar. Në këto rrethana, Komisioni vlerëson të marrë në shqyrtim rastin e saj në një kohë të dytë.

{...}, pas përfundimit të studimeve është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gramsh, detyrë të cilën e ka mbajtur deri në datën 13.5.2000, kur me vendimin datë 10.05.2000 të ish-KLD-së ajo lirohet nga detyra e gjyqtares me kërkesën e saj dhe është emëruar ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë, detyrë të cilën e ka mbajtur deri më 01.03.2011. Me urdhrin datë 9.5.2012, KLD-ja ka urdhëruar emërimin e znj. {...}, si specialiste pranë IKLD-së. Me vendimin datë 18.11.2016, znj. {...} është emëruar inspektore pranë IKLD-së. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 312, datë 19.12.2019, ka vendosur ndër të tjera: “1. Të deklarojë pasjen e statusin “Magjistrat” për znj. {...}. 2. Znj. {...} të vijojë komandimin në detyrën e nëpunësit përgjegjës pranë Njësisë së Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor deri në një vendimmarrje tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

Znj. {...} i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar. KPK, me vendimin nr. 542, datë 20.06.2022 ka vendosur: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit {...}, inspektore në Inspektoratin e ish-KLD-së, sot KLGJ.” Kundër këtij vendimi znj.

{...} ka ushtruar ankim dhe është në pritje të shqyrtimit të tij. Në kushtet kur znj. {...} është aktualisht nën efektin e një mase disiplinore, Komisioni vlerëson të marrë në shqyrtim rastin e saj në një kohë të dytë.

Propozimet përkatëse për Mbledhje Plenare

Bazuar sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor:

Fillimin e procedurës së transferimit për gjyqtarët që aktualisht rezultojnë jashtë strukturës organizative të gjykatave ku janë të caktuar në mënyrë të përhershme, duke iu kërkuar secilit gjyqtar të evidentuar më lart në relacion, të ushtrojë të drejtën e zgjedhjes për t'u transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme në gjykatat e të njëjtit nivel e së njëjtës lëndë me pozicionin e mëparshëm, si më poshtë:

Për z. {...}, i propozohet:

i) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në fushën e së drejtës penale;

ii) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në fushën e së drejtës penale.

iii) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në fushën e së drejtës civile;

Për znj. {...}, i propozohet:

i) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në fushën e së drejtës civile;

ii) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në fushën e së drejtës penale.

iii) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në fushën e së drejtës civile;

Për znj. {...} i propozohet:

i) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në fushën e së drejtës penale;

ii) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në fushën e së drejtës civile;

iii) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në fushën e së drejtës civile;

Për znj. {...}, i propozohet:

i) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;

ii) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në fushën e së drejtës penale;

iii) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në fushën e së drejtës penale.

Për znj. {...}, i propozohet:

i) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në fushën e së drejtës penale;

ii) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në fushën e së drejtës civile;

iii) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në fushën e së drejtës civile;

Për znj. {...}, i propozohet:

i) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në fushën e së drejtës civile;

ii) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në fushën e së drejtës penale.

iii) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në fushën e së drejtës civile;

Për z. {...}, i propozohet:

i) nga një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; pasi vetë profili i tij nuk lejon transferimin e detyrueshëm në lëndë të tjera.

Ky është me pak fjalë relacioni. Ndërkohë, me shpërndarjen e këtij relacioni në mënyrë tempestive ka ardhur më datën 21.11.2023 nga gjyqtarja {...}, është dërguar një e-mail me përmbajtje ankimi, të cilën do të duhet ta relatoj:

“Jam vënë në dijeni se nga ana juaj është përgatitur akti “relacion për fillimin e

procedurës së transferimit të gjyqtarëve për shkak të suprimimit të pozicioneve në gjykatën ku janë caktuar në mënyrë të përhershme”. Gjithashtu jam vënë në dijeni sipas aktit tuaj pasqyrimi i numrit të magjistratëve gjyqtarë sipas strukturave organizative në fakt në gjykatat e të gjitha niveleve (16 nëntor 2023), Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka në strukturë 80 gjyqtarë, organika në fakt 63, pra ka 17 pozicione të lira. Konstatohet se nga ana juaj është bërë një shpërndarje e këtyre pozicioneve si vijon: z. {...}, penale Tiranë, civile Tiranë, penale Durrës; znj. {...} emëruar më 10.10.2012, civile Tiranë, civile Durrës, penale Durrës; znj. {...} emëruar më 29.01.2020, civile Tiranë, penale Tiranë, civile Durrës; znj. {...} emëruar më 27.10.2020, administrative Tiranë, penale Tiranë, penale Durrës; znj. {...} emëruar më 30.07.2019, civile Tiranë, penale Tiranë, civile Durrës; znj. {...} emëruar në 2016, civile Tiranë, penale Tiranë, civile Durrës; zoti {...} emëruar më 24.11.1994, administrative Tiranë, administrative Tiranë.

Të gjithë gjyqtarët, veç meje, i janë propozuar nga dy pozicione në Tiranë. Si është bërë ky dallim nga ana juaj, mbi bazën e cilit kriteri?

Në relacionin tuaj keni thënë se ka rezultuar se në gjykatat me një numër të konsiderueshëm pozicionesh të tilla janë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Por sipas relacionit tuaj në fillimin e procedurës së transferimit për gjyqtarët që aktualisht rezultojnë jashtë strukturës organizative të gjykatave ku janë caktuar në mënyrë të përhershme dhe të kërkimit për të ushtruar të drejtën e përzgjedhjes për t’u transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme në gjykatat për të cilat gëzojnë kriteret e kërkuara nga pozicioni janë marrë në konsideratë nga Komisioni: Pështetë specifike e ngarkesës së seksioneve të gjykatave pritëse; Përvoja që gëzon gjyqtari në fushën specifike; Kriteret e kërkuara nga pozicioni i ofruar në gjykatën pritëse. Si është analizuar përvoja specifike nga ana juaj duke bërë diferencë mes meje në kushtet kur kam mbi 11 vjet vjetërsi në funksion? Kam ushtruar funksionin në gjykatë në dy seksione, si civile dhe penale. Kam qenë e komanduar ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë pranë Kolegjit Penal. Kam qenë pjesë e skemës së delegimit duke gjykuar si çështjet penale ashtu edhe civile pranë gjykatës së apelit. Kam

dy vlerësime të njëpasnjëshme "Shkëlqyeshëm" me gjyqtarët e tjerë me më pak vjetërsia se unë, disa prej tyre pa e ushtruar 6 muaj funksionin si gjyqtar ose duke ushtruar në gjykata me ngarkesë minimale çështjesh, si për shembull në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë (teorikisht duhet t'i referohet zonjës {...}).

Kërkoj të mbahet parasysh nga ana juaj në ofrimin e pozicioneve, së pari vjetërsia në funksion të së cilës lidhet me përvojën specifike që citoni si kriter në relacionin tuaj, në kushtet kur sipas relacionit tuaj ka 17 vende të lira aktualisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe 7 gjyqtarë të cilëve u suprimohet pozicioni i përhershëm, të më ofroni ashtu sikur keni ofruar edhe gjashtë gjyqtarëve të tjerë pozicione të lira në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në renditjen e pozicioneve nga ana juaj, nëse mbahet parasysh vjetërsia, dhe kjo është e rëndësishme, dhe përvoja, si dhe kriteret nga pozicioni i ofruar, unë jam gjyqtarja që do të renditej e dyta pas gjyqtarit {...}. Kështu që të dy pozicionet në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në asnjë rast nuk do duhet të më ofrohen mua.

Ju uroj punë të mbarë.”

Ky është e-maili tempestiv i ardhur atë ditë që është shpërndarë relacioni pranë kolegëve, për të cilin i vetmi rekomandim është “ta lexojë me kujdes relacionin” pasi në të janë respektuar të gjithë kriteret, janë përmbushur çdo kërkim të bërë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor në respekt të ligjit, në mënyrë të veçantë edhe në këtë ristrukturim të gjykatave, propozimet janë në përputhje me kriteret të cilat ajo disponon dhe në mënyrë të veçantë me përvojën që ajo ka dhe pozicionet të cilat kanë kërkimet e tyre specifike.

Gjithashtu është propozuar pranë, të themi, lënde të caktuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kjo për efekt të vazhdimësisë së gjykimit që ajo aktualisht ka në dorë, për të mos krijuar më tepër amulli në lënien e tyre dhe vijimin në lëndë tjetër të gjykimeve, pasi kjo rëndon mbi qytetarin shqiptar.

Kalojmë tek letra e hapur e cila sot ka ardhur në e-mailin institucional timin, por ndoshta edhe tuajin, e cila daton në Lushnjë, më datë 18 janar 2024. Në përfundim të saj, pas shprehjes së respektit, përfaqëson gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}. Është një letër pa firmosur, pa

vulosur, pa logo, e ardhur në e-mailin zyrtar të KLGJ-së nga serveri i Gjykatës Administrative Lushnjë. Jam i detyruar ta lexoj, duke qenë që nuk ka formën e anonimatit.

Mos ta lexoj?

Ok! Nëse e keni lexuar, po ju shkurtoj kohë.

Ky ishte materiali dhe propozimet përkatëse.

Naureda Llagami: Atëherë, kam një propozim, do i kalojmë me grupe? Për shembull hedhim në votim midis z. {...} dhe znj. {...}, dhe më pas...?

Alban Toro: Ndjesë sepse ngarkesa ka qenë e tillë. Ndërkohë që relatori e kishte përgatitur relacionin dhe me kohën e kërkuar nga kolegët për t'u njohur me të, aktualisht është krijuar një fakt i ri juridik, i cili ka modifikuar strukturën e Gjykatës Berat. Zoti {...}, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 574, datë 18.10.2022 është shkarkuar për shkak të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me vendimin e saj. Kështu që, aktualisht nga dy pozicione të lira në Gjykatën e Beratit, aktualisht janë reduktuar në një, me largimin e një prej anëtarëve të tij që ka ushtruar funksionet në mënyrë të përhershme, për shkak të vendimmarrjes së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Kjo është më e rëndësishme nga të gjitha ato që relatuam (letrat e hapura dhe të mbyllura).

Naureda Llagami: Atëherë, fillojmë pra me Gjykatën e Beratit, mendoj unë, dhe më pas me gjykatat e tjera.

Tek Gjykata e Beratit pra kemi një fakt të ri, ku kemi ndryshimin e pjesës së strukturës dhe nga ana tjetër, për shkak të kohës, Komisioni ka ardhur për dy kandidatë, ka ardhur për z. {...}, mbi strukturë, ka ardhur për zonjën {...}. Atëherë, kemi një qëndrim të Komisionit që për këto dy kandidatë, kush do konsiderohet?

Alban Toro: Atëherë, duke respektuar deri në fund edhe opinionin dhe vullnetin e kandidates e cila pati vërejtje për gjykatën të cilës i është propozuar, pra zonja {...} me të

drejtë ka identifikuar dhe ka bërë një renditje paraprake të kandidaturës ku z. {...} e ka renditur të parin për nga vjetërsia dhe vetë vinte e dyta për nga vjetërsia, kështu që teorikisht i bie që duke respektuar atë performancë që ne kemi kryer, ku kemi inkurajuar eksperiencat e vjetra, normalisht i bie që të propozohet zoti Biba për këtë pjesë, për t'u sistemuar në një strukturë të Gjykatës së Tiranës, në pritje të përfundimit të procedurës së vetting-ut nga ana e tij. Më pas pastaj do të procedohet, nëse do të krijohet ndonjë situatë tjetër për të bërë përfundimin. Ky është opinionimi ose propozimi i relatorit.

Naureda Llagami: Pra ju propozoni që mbi strukturë konsiderohet z. {...}.

Alban Toro: Në fakt kandidatja vetë e ka paracaktuar.

Naureda Llagami: Po, me situatën kur ishin dy vende.

Fatmira Luli: Të flas edhe unë?

Naureda Llagami: Me radhë.

Fatmira Luli: Atëherë, unë nuk jam dakord me propozimin e Komisionit, për arsye se për gjyqtarin {...} ne kemi një vendim në datë 13.03.2023, me të cilin, në momentin që ai është shkarkuar nga KPK, është vendosur deklarimi i mbarimit të caktimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe kemi vendosur transferimin e gjyqtarit të gjykatës së posaçme pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, duke filluar nga data 19.01.2021 deri në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj tij sipas ligjit “Për rivlerësimin kalimtar ...”. Pika tre e këtij vendimi “3. Në rast të konfirmimit në detyrë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, gjyqtari {...} gëzon të drejtën të zgjedhë për t'u transferuar në çdo pozicion që do të jetë i lirë në atë moment apo që pritet të bëhet i lirë brenda 6 muajve në Gjykatën e Shkallës së Parë në Juridiksionin e Përgjithshëm sikurse një gjë e tillë magjistratit ia garanton neni 44 i ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe

prokurorëve”.” Ndaj këtij vendimi {...} s’ka bërë ankim. Ky vendim është në fuqi. Kjo është praktika që kemi ndjekur edhe me gjyqtarin tjetër të Gjykatës së Posaçme {...}. Kështu që për këtë kemi një qëndrim dhe s’mund të ndryshojmë qëndrime sa herë ka individë të tjerë që duan të ndryshojnë praktikën.

Ndërsa për zonjën {...} është caktuar ndër të parat, që në mars ose prill të 2023, atëherë kur gjykata ishte në nevojë, është transferuar në Gjykatën e Tiranës, për shkak se gjykata nga e cila vinte nuk kishte çështje të mbartura, ishte në kushtet kur të tërë gjyqtarët kishin gjykuar një numër shumë të madh çështjesh. E kemi deleguar në skemë delegimi dhe e kemi hequr që andej, e kemi prishur skemën për nevoja të riorganizimit që iu bë sistemit gjyqësor nga harta e re gjyqësore. Kështu që mendoj që jo vetëm ligjërisht por edhe për shkak të kriterëve që përcakton neni 44, është vendi i saj që duhet të shpallet i suprimuar në Gjykatën e Beratit. Faleminderit!

Alban Toro: Kam një paqartësi.

Pra ajo që propozoni ju është që një gjyqtar i përkohshëm i vendosur në një pozicion/funksion të përhershëm, nuk është i tepërt në strukturë, ndërkohë që një gjyqtar i cili do të ushtrojë funksionin e përhershëm në atë pozicion ku është ... një minutë pra, ta mbaroj, se s’e kam mbaruar. Ta përkthejmë pastaj edhe pa terma teknik. Pra i caktuar në mënyrë të përhershme në gjykatë me dekret të Presidentit apo me vendim të KLGJ-së është jashtë strukture për efekt të identifikimit të personit apo gjyqtarit të identifikuar.

Fatmira Luli: Po, unë i qëndroj praktikës.

Alban Toro: Duke sjellë në vëmendjen tuaj që emri i zotit {...} është artikuluar si emergjente për t’u sistemuar nga vetë përfaqësuesit e Komisionit të Vlerësimit dhe Etikës, nëse mban mend vendimmarrjet e mëparshme. Sepse është bllokuar. Pra kur ka ardhur Komisioni, ka ardhur me një emër, ka qenë {...}, në mos u gabofsha, por në atë mbledhje është pezulluar, është marrë materiali për t’u ripunuar, sepse është dashur që të riintegrohen edhe inspektorët të cilët unë i citova, që përsëri nuk mund të shprehemi për ta, dhe zoti {...} i cili duhet sistemohej në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Ky ka qenë. Ke qenë

prezent bashkë me ne.

Mund t'ia pyesësh kërkueses që e ka bërë (i drejtohet zonjës Luli).

Nuk ka si të ketë akt, sepse ishte një diskutim kolegësh në një mbledhje seancë plenare.

Fatmira Luli: Unë flas mbi një vendim.

Të shprehemi sot ne për një veprim tjetër, ne duhet të anulojmë një vendim të cilin ne e kemi kristalizuar në bazë të ligjit.

Naureda Llagami: Fatmira, Albani dha qëndrimin e vet, ti ke qëndrimin tënd. Të kemi qëndrim për të gjithë qëndrimet. Duan fjalën edhe të tjerë.

Do ta hedhim në votim.

Fatmira Luli: ...dhe po i them që ne kemi bërë suprimime vetëm për vendet kur kanë qenë të përhershme. Shihni relacionin tuaj, shihni vendimin. Asnjë rast në pozicion të përkohshëm nuk kemi bërë suprimime. Të tërë personat kanë qenë të përhershëm, e para. E dyta, ky transferim ishte me kusht dhe ka një vendim KLGJ-je.

Naureda Llagami: Fjalën e ka Genta.

Gentiana Muçaj: Unë jam kundër zotit Toro. E mbështes plotësisht zonjën Luli, me shtesën që vendimi nr. 18 i Këshilli i Lartë Gjyqësor parashikon fuqinë juridike të këtij akti i cili është deri në përfundimin e procesit kalimtar të rivlerësimit kalimtar sipas ligjit 84/2016. Pra ky vendim është në fuqi deri në momentin që KPA do të shprehet. Ky vendim nuk është as revokuar, as shfuqizuar, as deklaruar i pavlefshëm, as nga gjykata po as nga vetë Këshilli.

Unë i uroj zotit {...} të kthehet në sistem dhe ia uroj me gjithë shpirt. Në momentin që kthehet zoti {...}, ne jemi të detyruar ta transferojmë në mënyrë të përhershme në një nga vendet që do jenë brenda juridiksionit të përgjithshëm, sipas nenit 44, pika 2, shkronja “b”, ky vendim është në fuqi dhe ne jemi të detyruar ta zbatojmë këtë

vendim.

Unë jam për zonjën {...} për ta deklaruar të suprimuar atë vend.

Naureda Llagami: Atëherë, kemi mendim tjetër?

Nëse jo, hedhim në votim midis kandidaturave. Si gjithmonë, do të hedhim propozimin për kandidaturën që propozon zonja Fatmira (pra jo të Komisionit), për të cilën u bashkua edhe zonja Genta, që do konsiderohet vend i suprimuar për zonjën {...}. Dhe, hedhim në votim propozimin për zonjën {...}, për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares znj. {...}, për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, ku është caktuar në mënyrë të përhershme. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Pjesërisht dakord, jo plotësisht dakord. I qëndroj relacionit që kemi bërë paraprakisht ne si Komision. Vazhdoj të insistoj dhe të them që të dy kandidaturat duhet të vinin sipas argumentimit që kemi dhënë në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, njëri në pozicionin e përhershëm, tjetri i përkohshëm. Faleminderit!

Naureda Llagami: Dakord.

(Miratohet propozimi me shumicë votash.)

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares znj. {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, ku është caktuar në mënyrë të përhershme.

2. T'i kërkohet gjyqtares znj. {...}, të ushtrojë të drejtën e zgjedhjes për t'u transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme në gjykatat e të njëjtit nivel e së njëjtës lëndë me pozicionin e mëparshëm, si më poshtë:

i) Një pozicion të lirë të përhershëm, në fushën e së drejtës civile, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;

ii) Një pozicion të lirë të përhershëm, në fushën e së drejtës civile, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;

iii) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në fushën e së drejtës penale.

3. E drejta e zgjedhjes sipas pikës 1 duhet të ushtrohet brenda 3 (tre) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

4. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtares [...].

Naureda Llagami: Lidhur me aktin e z. {...}, ky do merret në shqyrtim, sikurse vendosi shumica, në momentin kur do kemi një vendim përfundimtar nga ana e KPA-së.

Naureda Llagami: Kalojmë në grup-aktet e tjera që bëjnë fjalë për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares znj. {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme.

Po, zonja Plaku!

Irena Plaku: Atëherë, për shkak të letrës që u referua edhe nga z. Toro, duke qenë se një nga ato që është dërguar emri të paktën, e-mailin, është një nga familjaret e mia, unë kërkohet që të përjashtohem nga... domethënë mos të marrë pjesë në këtë votimin, për shkak se është gjykata administrative.

Naureda Llagami: Atëherë, zonja Plaku nuk futet në shqyrtimin e këtij projekt-akti.

Atëherë, përpara se këtë projekt-akt ta hedhim në votim, unë në fakt kisha një propozim. Do të doja që, zonjës {...}, të ishte në të njëjtin propozim që i janë bërë edhe

dy vajzave të tjera që punojnë në KLGJ, t'i propozohen të njëjtat gjykata respektive. Duke qenë që kam një mendim të kundërt nga relatori, atëherë do të doja që ta hidhnim në votim. Pra më konkretisht, znj. {...} mos t'i propozohet Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, për t'i propozuar sikurse i janë propozuar edhe gjyqtareve të tjera, t'i propozohet një pozicion i lirë i përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në fushën e së drejtës civile.

(Zonja Muçaj kërkon fjalën.)

Gentiana Muçaj: Më falni, se nuk jam mësuar me procedurën.

Jemi në votim?

Jo, unë doja një sqarim.

Unë jam totalisht kundra suprimimit të këtyre dy vendeve për shkak të nenit 57 të ligjit 96/2016 dhe kundër jo vetëm për propozimin, por kundra shpalljes së këtyre dy vendeve mbi strukturë. Për mua nuk ka mbaruar komandimi. Nuk ka mbaruar komandimi. S'duhet të shpallen. Të vijë përfundimi i afatit, ose në rast se ka një kërkesë nga zonjat për të përfunduar komandimin përpara afatit. Unë nuk e di që ka. Sepse kemi edhe gjyqtarë të tjerë të komanduar. 11.04.2025 i mbaron znj. {...} dhe 21.06.2024 i mbaron znj. {...} dhe në këto momente që i mbaron, shprehet Këshilli.

Naureda Llagami: Po! Ky është një qëndrim tjetër.

Atëherë, duke qenë se ky është një qëndrim në tërësi, atëherë hedhim në votim propozimin e zonjës Muçaj dhe më pas kalojmë tek propozimi që unë bëra për aktin konkret. Kështu që, jeni dakord që suprimimi për strukturën e Gjykatës Fier të mos konsiderohet, pra nuk jemi në momentet që duhet të bëhet kjo gjë?

Ilir Rusi: Kundër.

Gentiana Muçaj: Pro.

Ridvan Hado: Kundër.

Alban Toro: Kundër, pasi e konsideron të papranueshëm që një gjyqtar të mos ketë një gjykatë. Ligji ka sanksionuar dhe vetë statusi sanksionon që gjyqtari është i palëvizshëm (për raste të caktuara ai mund të lëvizet), por në çdo rast gjyqtari do duhet të

ketë të përcaktuar një gjykatë ku qoftë t'i bëhen edhe komunikimi i njoftimeve për të.

Fatmira Luli: Kundër propozimit për shkak se ne këtë qëndrim kemi mbajtur edhe në raste të mëparshme, pavarësisht nga koha kur u ka mbaruar komandimi. Ne kemi gjykuar që kur u është suprimuar jemi shprehur për gjyqtarët. Kështu që, gjykoj që s'duhet...

Markelian Koça: Kundër.

Yllka Rupa: Kundër.

Emona Muçi: Kundër.

Klodian Kurushi: Kundër, me një argumentim shumë të shkurtër. Nëse do ta pranoni këtë propozim atëherë ne nuk kemi bërë asnjë gjë për Gjykatën e Fierit, sepse në strukturë do jenë prapë dy tepër. Ato do jenë. Dhe dy persona, dy gjyqtarë në Gjykatën e Fierit duhet të lëvizin. Nëse i lëmë kështu "stand by", Gjykata e Fierit do jetë me tre.

Naureda Llagami: Kundër, për shkak të qëndrimit që Këshilli ka mbajtur.

(Nuk miratohet propozimi i znj. Muçaj.)

Naureda Llagami: Atëherë, duke qenë që propozimi i zonjës Muçaj, u rrëzua, kalojmë në propozimin që unë bëra, pra që zonjës {...} t'i propozohen të njëjtat gjykata, sikurse i janë propozuar zonjës {...} dhe znj. {...}. Kështu pra, konkretisht largohet propozimi për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe të bëhet propozimi për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në fushën e së drejtës civile. Jemi dakord në qoftë se e vlerësoni?

Ilir Rusi: Dakord.

Gentiana Muçaj: Kundra propozimit për Gjykatën Administrative dhe pro jush.

Ridvan Hado: Kundër.

Alban Toro: Natyrisht që jam kundër edhe me këtë propozim pasi ai nuk përkon me fushën e interesit të magistrates e cila publikisht ka pretenduar dhe pretendon të konkurrojë në lëvizje paralele dhe në përgjithësi vendimmarrjet e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës kanë qenë gjithmonë në përputhje me vullnetet e gjyqtarit edhe në ato momente kur dispozita ligjore kërkon që ta transferojë pa pëlqimin përkatës dhe në ato raste KZHK-ja është përpjekur që çdo gjë të jetë në përputhje me vullnetin e

magjistratit.

Fatmira Luli: Kundra.

Markelian Koça: Pro.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Pro.

Klodian Kurushi: Kundër propozimit.

Naureda Llagami: Pro propozimit.

(Miratohet propozimi me shumicë votash, 6 vota pro dhe 4 vota kundër.)

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarës znj. {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, ku është caktuar në mënyrë të përhershme.

2. T'i kërkohet gjyqtarës znj. {...}, të ushtrojë të drejtën e zgjedhjes për t'u transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme në gjykatat e të njëjtit nivel me pozicionin e mëparshëm, si më poshtë:

i) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në fushën e së drejtës penale;

ii) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në fushën e së drejtës penale;

iii) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në fushën e së drejtës civile.

3. E drejta e zgjedhjes sipas pikës 1 duhet të ushtrohet brenda 3 (tre) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

4. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër.
Përpara se të kalojmë, të përfshihet në mbledhje znj. Plaku.
Projekt-akti tjetër ka të bëjë me fillimin e procedurës së transferimit për znj. {...},
propozimet që kanë ardhur nga Komisioni. Jemi dakord me propozimin e ardhur?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares znj. {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, ku është caktuar në mënyrë të përhershme.

2. T'i kërkojë gjyqtares znj. {...}, të ushtrojë të drejtën e zgjedhjes për t'u transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme në gjykatat e të njëjtit nivel e së njëjtës lëndë me pozicionin e mëparshëm, si më poshtë:

i) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në fushën e së drejtës civile;

ii) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në fushën e së drejtës civile;

iii) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në fushën e së drejtës penale.

3. E drejta e zgjedhjes sipas pikës 1 duhet të ushtrohet brenda 3 (tre) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

4. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Më pas kemi znj. {...} për të cilën ka ardhur propozim nga Komisioni. Jeni dakord me propozimin e ardhur nga Komisioni në tre gjykatat respektive: Tiranë, në fushë civile; Tiranë, në fushën e së drejtës penale; Durrës, në fushën e së drejtës civile. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

Naureda Llagami: Kalojmë tek z. {...}, që ka të bëjë me fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarit {...} për shkak të suprimimit nga pozicioni në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, në pozicionin në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Jemi dakord me propozimin?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimit të Komisionit.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i fundit që ka të bëjë me gjyqtaren {...}. Edhe znj. {...} i janë propozuar tre pozicione, dy pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në fushën e së drejtës civile dhe penale dhe një pozicion në fushën e së drejtës civile, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Jemi dakord me propozimin e Komisionit?

Illir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet edhe ky projekt-akt sipas propozimit të Komisionit.

Naureda Llagami: Po, zoti Kurushi!

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Vetëm marr shkas nga përmbajtja e letrës së hapur të bërë nga kolegët tanë në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Lushnjë. Do doja vëmendjen minimale, sepse nuk dua t'ju marrë më tepër kohë seç duhet. Përmbajtja e letrës nuk shkon me gjuhën e përdorur nga ata që e kanë përpiluar atë letër nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Është përdorimi i një gjuhe jo të përshtatshme nga magjistrati që nuk bie ndesh as me frymën e të gjithë ligjeve në funksion të reformës në drejtësi, as edhe me pozicionin e tyre në raport me Këshillin e Lartë Gjyqësor, i referohem këtu nenit 7. Referencat ligjore në këtë ligj nuk janë ato që duhen, pra i referohen në referencat ligjore, nenit 39, nenit 8, nenit 43 që nuk kanë lidhje fare me çështjen për të cilën ne po trajtojmë aktualisht. Nuk më vret shumë pjesa e referencave ligjore, por vënia në dyshim në përdorimin e gjuhës të integritetit moral dhe profesional të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kjo është një çështje që na prek ne drejtpërdrejt, sepse nëpërmjet shqetësimeve që ata ngrenë, vënë në dyshim edhe parimin e rëndësishëm të cenimit të besimit të publikut, si nga ana jonë si gjyqtarë dhe kolegë të tjerë që jemi pjesë e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ashtu edhe nga ana e tyre që janë gjyqtarë magjistratë në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Lushnjë.

Përvoja e këtyre gjyqtarëve nuk është aq e madhe. Është një eksperiencë modeste afërsisht prej 3 vjetësh punë si gjyqtarë, dhe në këtë pikë duhet të ishin edhe më të matur, ndoshta mund të jetë mungesë përvoja në mënyrën se si ato i adresojnë shqetësimet e tyre përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në këtë pikë, unë propozoj që kjo letër të mos mbesë në kuadrin e një veprimi, po themi, pa veprim dhe propozoj që kjo letër të jetë pjesë e vlerësimit etik dhe profesional që ne, Këshilli i Lartë Gjyqësor e ka për detyrë për t' i realizuar si një pjesë e detyrave tona, për të gjithë gjyqtarët magjistratë që janë sot në detyrë. Kështu që në këtë pikë, mendoj që duhet të kemi një reagim jo vetëm deklarativ, por më tej, të verifikohen edhe më tej etika, nëse ka ndonjë problem në lidhje me mënyrën se si kanë artikuluar dhe se si ata e kanë ngritur shqetësimin në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi!

Atëherë, nga ana e Komisionit të Etikës akti është vënë në dispozicion, e kanë, kemi marrë dijeni që të gjithë, kështu që mbetet në vlerësimin e Komisionit gjatë shqyrtimeve që mund të kenë.

Klodian Kurushi: Edhe të Këshillit.

Naureda Llagami: Edhe të Këshillit në fund.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.01.2024)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 13, datë 18.01.2019 të KLGJ-së “Mbi ngritjen dhe përbërjen e komisioneve të përhershme”, i ndryshuar”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.²

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:45 dhe mbaroi në orën 17:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|--------------------|-------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Emona Muçi | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Irena Plaku | (anëtare) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |

² Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 4-ta sipas rendit të ditës.

9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
10. *Markelian Koça* (anëtar)
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
7. *BIRN.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtim i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 13, datë 18.01.2019 të KLGJ-së “Mbi ngritjen dhe përbërjen e komisioneve të përhershme”, i ndryshuar”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Shkurtimisht në fakt, kemi edhe një akt tjetër që ka të bëjë edhe një herë me rishikimin e ndarjes së Komisioneve. Kemi bërë, ndoshta, unë në cilësinë e Kryetares një lapsus, duke lënë zotin Ridvan në të dy Komisionet si zëvendësues dhe tek Komisioni i Karrierës, por, edhe tek Komisioni i Vlerësimit. Atëherë, propozimi që kam për ta korrigjuar këtë projekt-akt është që në Komisionin e Vlerësimit të mos jetë z. Ridvan, pavarësisht akteve që ka marrë dhe që do bëhen pjesë e diskutimeve në mbledhjet në vijim, por të jetë zonja Gentiana Muçaj (si zëvendësuese gjithmonë).

Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

(*Miratohet akti.*)

Atëherë, mund të bëjmë 5 minuta pushim dhe për t'u bashkuar prapë për të vijuar mbledhjen.

Faleminderit!

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.01.2024)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për caktimin e relatorit në procedurat e verifikimit të kancelarit në detyrë dhe kandidatëve për në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës për ndihmës ligjorë, të papërfunduara për shkak të mbarimit të mandatit të anëtareve të Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. {...} dhe znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.³

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:45 dhe mbaroi në orën 17:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |

³ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 2-ta sipas rendit të ditës.

7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
9. *Markelian Koça* (anëtar)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në këtë çështje dhe në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, e cila u largua pas trajtimit të çështjes së tretë. Vijimi i mbledhjes drejtohet nga z. Rusi.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
7. *BIRN.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtim i projektvendimit “Për caktimin e relatorit në procedurat e verifikimit të kancelarit në detyrë dhe kandidatëve për në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës për ndihmës ligjorë, të papërfunduara për shkak të mbarimit të mandatit të anëtareve të Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. {...} dhe znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Rifillon mbledhja pas 30 minutash pushim.

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sikundër u

njoftua edhe nga Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, e ka të pamundur për të qenë prezent në këtë mbledhje për më tej. Kështu që mbledhja në vijim do të drejtohet nga unë Ilir Rusi, Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas rendit të ditës, vazhdojmë me pikën 2 të këtij rendi dite (*i referohet rendit të shpërndarë*) që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e relatorit në procedurat e verifikimit të kancelarit në detyrë dhe kandidatëve për në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës për ndihmës ligjorë, të papërfunduara për shkak të mbarimit të mandatit të anëtareve të Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. {...} dhe znj. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën relatores znj. Luli.

Fatmira Luli: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Me mbarimin e mandatit të... në kuadrin e verifikimit të kancelarëve z. {...}, kancelar në detyrë, që i kishte rënë me short anëtares së Komisionit të Administrimit dhe Buxhetit znj. {...}, njëkohësisht edhe ndihmësit {...}, {...}, {...}, kandidatë për në formimin fillestar për ndihmës ligjorë pranë Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2023-2024, ishin caktuar me short kësaj anëtareje.

Në kushtet kur zonja Gentiana Muçaj zëvendëson zonjën {...} dhe për shkak të faktit që ajo ka një mandat të ri dhe anëtarja tjetër unë Fatmira Luli jam në përfundim të mandatit, në Komision u gjykua që vazhdimësinë e çështjeve të gjyqtares Marçela të vazhdojë gjyqtarja tjetër anëtare e këtij Komisioni zonja Gentiana Muçaj.

Kështu që i propozohet këtij Këshilli që në mbledhje plenare të vendosi caktimin e znj. Gentiana Muçaj relatores të procedurës së verifikimit të kancelarit në detyrë, të papërfunduar për shkak të mbarimit të mandatit të anëtares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. {...}, si më poshtë: i. {...}. Znj. {...} ka qenë si anëtare zëvendësuese e Komisionit.

Caktimin e znj. Gentiana Muçaj relatores të procedurës së verifikimit të kandidatëve për në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për ndihmës ligjorë, në vitin akademik 2023-2024, të papërfunduara për shkak të mbarimit të mandatit të anëtares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. {...}, si më poshtë: znj. {...}, znj. {...}, z. {...}.

Një kopje e vendimit i njoftohet kancelarit dhe kandidatëve për relatorin e ri që kanë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Luli!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për caktimin e relatorit në procedurat e verifikimit të kancelarit në detyrë dhe kandidatëve për në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës për ndihmës ligjorë, të papërfunduara për shkak të mbarimit të mandatit të anëtareve të Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. {...} dhe znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Caktimin e znj. Gentiana Muçaj relatore të procedurës së verifikimit të kancelarit në detyrë, të papërfunduar për shkak të mbarimit të mandatit të anetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. {...}, si më poshtë:

i. {...}.

2. Caktimin e znj. Gentiana Muçaj relatore të procedurës së verifikimit të kandidatëve për në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për

ndihmës ligjorë, në vitin akademik 2023-2024, të papërfunduara për shkak të mbarimit të mandatit të anëtares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. {...}, si më poshtë:

- i. znj. {...};
- ii. znj. {...};
- iii. z. {...}.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet kancelarit në detyrë dhe kandidatëve për ndihmës ligjorë sipas pikës 65 të vendimit nr. 424, datë 12.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.01.2024)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për përbërjen e komisionit të përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, për vitin 2024”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.⁴

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:45 dhe mbaroi në orën 17:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |

⁴ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 3-ta sipas rendit të ditës.

8. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
9. *Markelian Koça* (anëtar)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në këtë çështje dhe në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, e cila u largua pas trajtimit të çështjes së tretë. Vijimi i mbledhjes drejtohet nga z. Rusi.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
7. *BIRN.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtim i projektvendimit “Për përbërjen e komisionit të përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, për vitin 2024”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Ilir Rusi: Sipas rendit të ditës, vazhdojmë me pikën 3 të këtij rendi dite (*i referohet rendit të shpërndarë*) që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përbërjen e komisionit të përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një

gjqytari, për vitin 2024”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën relatores znj. Luli.

Fatmira Luli: Faleminderit!

Komisioni i Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, ka një afat 1-vjeçar në bazë të ligjit, pikës 4, të nenit 119 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe këto vendime janë vendime të formës së prerë. Në përbërje ligji përcakton që përbërja e Komisionit është me dy anëtarë jogjyqtarë dhe një gjyqtar.

Fillimisht, me vendimin e tij nr. 170, datë 28.05.2020 është ngritur komisioni i për shqyrtimin e këtyre ankimeve. Me vendimin nr.171 është caktuar përbërja e këtij Komisioni. Me vendimin nr. 200/2020 është miratuar rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për arkivimin e ankimeve dhe pushimit të hetimeve ndaj një gjyqtari.

Me vendimin nr. 34, datë 19.01.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi përbërjen e Komisionit për vitin 2023 për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit.

Në zbatim të rregullores dhe të ligjit, meqenëse ky komision është me përbërje 1-vjeçare dhe çdo vit duhet përcaktuar përbërja e tij e re, i propozohet këtij këshilli që të hidhen në short anëtarët e rinj të këtij Komisioni, dy anëtarë zëvendësues, konkretisht një anëtar gjyqtar zëvendësues dhe një anëtar jogjyqtar zëvendësues.

Meqenëse ne anëtarët e vjetër jemi në fund të mandatit, sugjerohet që anëtarët që do hidhen në këtë proces, të jenë anëtarët që kanë mandat të ri.

Hedhja e shortit të bëhet sipas procedurës dhe radhës së mëposhtme:

Përzgjedhja e anëtarëve jogjyqtarë - Në një vazo futen goglat për anëtarët jogjyqtarë, Tërhiqen sipas procedurës së zakonshme që ne bëjmë me goglat këtu. Dhe pastaj bëhet përzgjedhja e anëtarit gjyqtar po kështu nëpërmjet procedurës me gogla ku futet shiriti i letrës me emrat e anëtarëve gjyqtarë.

Drafti, në përfundim, vendoset përbërja e Komisionit me dy anëtarë jogjyqtarë dhe një gjyqtar dhe anëtarë zëvendësues të tij që duhet të jenë po përsëri dy anëtarë, një

anëtar jogjyqtar dhe një gjyqtar.

Komisioni ushtron veprimtarinë e tij për vitin akademik 2024 dhe objekti i veprimtarisë, ankimimet e ardhura deri tani dhe për të cilat nuk ka ende një vendimmarrje, dorëzohen pranë Komisionit të Përkohshëm të krijuar në pikën 1 të këtij vendimi, nga anëtari i cili nuk vijon të jetë anëtar i këtij Komisioni. Në çdo rast dokumentohet procesi i dorëzimit të këtyre vendimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Luli!

Ka diskutime për sa është parashtruar deri tani nga zonja Luli?

(Diskutojnë anëtarët për procedurën e hedhjes së shortit.)

Ilir Rusi: Në vijim të shqyrtimit të kësaj pike, zonja Luli ka diçka në raport me atë çfarë ka parashtruar deri tani.

Fatmira Luli: Faleminderit Zëvendëskryetar!

Atëherë, meqenëse unë dhe z. Alban Toro jemi me mandat të mbaruar dhe presim zëvendësuesit dhe koha jonë mund të jetë në varësi të anëtarëve zëvendësues, propozoj që anëtarë të këtij Komisioni të jenë zëvendëskryetari dhe zonja Yllka Rupa dhe anëtar zëvendësues të jetë njëri nga ne të dy (në gjykim të anëtarëve ose të hidhet në short ose të vendoset me marrëveshje midis dy anëtarëve zëvendësues). Kjo për efekt të vazhdimësisë së gjatë të këtij afati 1-vjeçar të këtij komisioni dhe të mos ngarkojmë mbledhjet e Këshillit me vendimmarrje të shpeshta në varësi të të qenit ose të vazhdimësisë sonë si anëtarë të këtij Këshilli. Faleminderit!

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj parashtrëse, ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, administrata të përgatisë hedhjen e shortit sipas mekanizmit që u parashtrua së fundmi nga zonja Luli si relatorë dhe u dakordësua nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Procedura e shortit si vijon:

Vendosen në enën e parë të qelqit shiritat e letrës me emrat e anëtarëve gjyqtarë: znj. Gentiana Muçaj, znj. Irena Plaku, znj. Emona Muçi, z. Ridvan Hado, z. Klodian Kurushi, z. Markelian Koça.

Përzgjidhet emri i anëtarit: znj. Irena Plaku.

Përzgjidhet emri i anëtarit zëvendësues: z. Markelian Koça.

Vendosen në enën e qelqit shiritat e letrës me emrat e anëtarëve jogjyqtarë, për anëtarin zëvendësues, ku shorti do të hidhet vetëm midis z. Alban Toro dhe znj. Fatmira Luli.

Përzgjidhet emri i anëtarit: znj. Fatmira Luli.

Ilir Rusi: Keni diskutime në lidhje me hedhjen e shortit.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdohet me votimin e projektvendimit përkatës, duke përditësuar edhe të dhënat që dolën nëpërmjet shortit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përbërjen e komisionit të përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, për vitin 2024”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përbërja e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve Kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari (KPSHA), për vitin kalendarik 2024, është si më poshtë:

1. Znj. Irena Plaku – anëtar;
2. Znj. Yllka Rupa – anëtar;
3. Z. Ilir Rusi – anëtar.

Anëtarë zëvendësues të këtij Komisioni të Përkohshëm janë:

1. Z. Markelian Koça – anëtar;
2. Znj. Fatmira Luli – anëtar.

2. Komisioni ushtron veprimtarinë e tij bazuar në Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari”, miratuar me vendimin nr. 200, datë 11.06.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Ankimimet objekt i veprimtarisë së KPSHA, të ardhura deri tani dhe për të cilat nuk ka ende një vendimmarrje, dorëzohen pranë Komisionit të Përkohshëm të krijuar në pikën 1 të këtij vendimi, nga anëtari i cili nuk vijon të jetë anëtar i këtij Komisioni. Në çdo rast dokumentohet procesi i dorëzimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.01.2024)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 302, datë 05.06.2023 “Për ngritjen e komisionit të përkohshëm për verifikimin e kushteve dhe dokumentacionit që duhet të plotësojë magjistrati (gjyqtar) për të përfituar kredi për banim, si dhe miratimin e listës së magjistratëve (gjyqtarë) përfitues nga skema e subvencionimit të interesave të kredisë”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, relatore znj. Fatmira Luli.⁵

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:45 dhe mbaroi në orën 17:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |

⁵ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 5-ta sipas rendit të ditës.

6. *Irena Plaku* (anëtare)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
9. *Markelian Koça* (anëtar)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në këtë çështje dhe në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, e cila u largua pas trajtimit të çështjes së tretë. Vijimi i mbledhjes drejtohet nga z. Rusi.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
7. *BIRN.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 302, datë 05.06.2023 “Për ngritjen e komisionit të përkohshëm për verifikimin e kushteve dhe dokumentacionit që duhet të plotësojë magjistrati (gjyqtar) për të përfituar kredi për banim, si dhe miratimin e listës së magjistratëve (gjyqtarë) përfitues nga skema e subvencionimit të interesave të kredisë”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, relatore znj. Fatmira Luli.

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje, meqenëse pika 4 e saj tashmë është e

shqyrtuar, vazhdojmë me pikën 5, shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 302, datë 05.06.2023 “Për ngritjen e komisionit të përkohshëm për verifikimin e kushteve dhe dokumentacionit që duhet të plotësojë magjistrati (gjqqtar) për të përfituar kredi për banim, si dhe miratimin e listës së magjistratëve (gjqqtarë) përfitues nga skema e subvencionimit të interesave të kredisë”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën relatores znj. Luli.

Fatmira Luli: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Me vendimin nr. 302, datë 05.06.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur ngritja e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kushteve dhe dokumentacionit që duhet të plotësojë magjistrati (gjqqtar) për të përfituar kredi për banim, si dhe miratimin e listës së magjistratëve (gjqqtarë) përfitues nga skema e subvencionimit të interesave të kredisë, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në këtë komision janë zgjedhur anëtarë zotërinjtë: Fatmira Luli, Alban Toro dhe Dritan Hallunaj, i cili më 12 dhjetor i ka mbaruar mandati dhe ka filluar detyrën si gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në vazhdimësi, ky Komision është ngritur me afat 1-vjeçar dhe i mbaronte afati, mandati i shqyrtimit të çështjeve deri më 31 dhjetor. Data në të cilën është krijuar ka qenë 05.06.2023 dhe afati për të cilën ka punuar ka qenë vetëm 6 muaj, për të cilin ka marrë disa vendime, të cilat i janë dërguar bankës për ekzekutimin e kredive.

Në këtë proces komunikimi ishte e domosdoshme që anëtarësia e këtij Komisioni të ishte e plotë për shkak të vendimmarrjeve të nisura dhe interpretimeve që Komisioni duhet të bëjë në zbatim të vendimit që ka marrë për miratimin e listës dhe kushteve që plotësojnë gjyqtarët për përfitimin e këtyre kredive.

Në këto kushte Komisioni i Strategjisë dhe i Buxhetit propozoi që përbërja e Komisionit të mos ndryshonte dhe të zgjidhej anëtari i tretë në vend të zotit {...}, për të vazhduar vazhdimësinë e këtij Komisioni në raport me kërkesën e re që ka ardhur, me shqyrtimin/trajtimin e asaj vendimmarrjeje të mëparshme që ka marrë ky Komision.

Për këtë shkak propozohet drafti, me pikën e parë: ndryshimin e pikës 1 të

vendimit nr. 302, datë 05.06.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor si më poshtë:

Ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kushteve dhe dokumentacionit që duhet të plotësojë magjistrati (gjyqtar) për të përfituar kredi për banim, si dhe miratimin e listës së magjistratëve (gjyqtarë) përfitues nga skema e subvencionimit të interesave të kredisë, i përbërë nga dy anëtar jogjyqtarë dhe një anëtar gjyqtar, si më poshtë:

1. Znj. Fatmira Luli, anëtare e KLGJ,
2. Alban Toro, anëtar i KLGJ,
3. Anëtari i ri që do të propozohet nga mbledhja.

2. Ndryshimin e pikës 5, të vendimit nr. 302, datë 05.06.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor si më poshtë:

Komisioni, do ta ushtrojë veprimtarinë e tij, për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij vendimi deri në afatin që gjykoj duhet të jetë 31 dhjetor 2024, për të pasur një afat njëvjeçar, në mënyrë që të tërë të gëzojnë të drejtën për të marrë pjesë, edhe anëtarët e tjerë të marrin pjesë në këtë Komision, sipas nevojave që do kenë gjyqtarët.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Luli!

Në vijim, për shkak të natyrës dhe dinamikës së këtyre akteve, përsëri zonja Luli ka diçka për të shtuar.

Fatmira Luli: Atëherë, më falni për mungesën e vëmendjes, por zëvendësues në këtë komision të përkohshëm është zonja Irena Plaku dhe zoti Ilir Rusi. Në kushtet kur përbërja e Komisionit me dy anëtarët e mëparshëm ngeli ajo që ishte në këtë vit që mbyllëm, propozoj që edhe zëvendësuesit të jenë të njëjtë dhe nga shorti për anëtarin që do të zëvendësojë këtë komision nga gjyqtarët, të mos jetë zonja Irena Plaku, për shkak se ajo është anëtare zëvendësuese në këtë Komision.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime për sa u parashtrua së fundmi nga zonja Luli?

Meqenëse nuk ka diskutime, administrata të vazhdojë me hedhjen e shortit sipas mekanizmit të prezantuar nga relatorja dhe të dakordësuar nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për sa nuk ka diskutime.

Procedura e shortit si vijon:

Vendosen në enën e qelqit shiritat e letrës me emrat e anëtarëve gjyqtarë: z. Markelian Koça, z. Klodian Kurushi, z. Ridvan Hado, znj. Emona Muçi, znj. Gentiana Muçaj.

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Anëtari i përzgjedhur i cili do të jetë pjesë e këtij Komisioni është z. Ridvan Hado.

Ilir Rusi: Faleminderit administrata!

Ka diskutime në lidhje me hedhjen e shortit dhe përmbajtjen e tij?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me miratimin/votimin e projektvendimit, duke marrë në konsideratë përditësimet sipas shortit.

Vazhdojmë me votimin e këtij projektvendimi sipas përditësimit të bërë pas hedhjes së shortit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për një ndryshim në vendimin nr. 302, datë 05.06.2023 “Për ngritjen e komisionit të përkohshëm për verifikimin e kushteve dhe dokumentacionit që duhet të plotësojë magjistrati (gjyqtar) për të përfituar kredi për banim, si dhe miratimin e listës së magjistratëve (gjyqtarë) përfitues nga skema e subvencionimit të interesave të kredisë”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Ndryshimin e pikës 1, të vendimit nr. 302, datë 05.06.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor si më poshtë:

Ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kushteve dhe dokumentacionit që duhet të plotësojë magjistrati (gjyqtar) për të përfituar kredi për banim, si dhe miratimin e listës së magjistratëve (gjyqtarë) përfitues nga skema e subvencionimit të interesave të kredisë, i përbërë nga dy anëtar jogjyqtarë dhe një anëtar gjyqtar, si më poshtë:

1. Znj. Fatmira Luli, anëtare e KLGJ,
2. Z. Alban Toro, anëtar i KLGJ,
3. Z. Ridvan Hado, anëtar i KLGJ.

2. Ndryshimin e pikës 5, të vendimit nr. 302, datë 05.06.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor si më poshtë:

Komisioni, do ta ushtrojë veprimtarinë e tij, për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij vendimi deri në datën 31.12.2024.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.01.2024)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Klodian Kurushi:

7.1 “Për një ndryshim në vendimin nr. 375, datë 13.07.2023 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në shkollën e magistraturës, për vitin akademik 2023-2024”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Klodian Kurushi.

7.2 “Për një ndryshim në vendimin nr. 390, datë 22.09.2021 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.⁶

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:45 dhe mbaroi në orën 17:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 2. Klodian Kurushi*** (anëtar)

⁶ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 6-ta sipas rendit të ditës.

- | | |
|--------------------------|------------------|
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Emona Muçi | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Irena Plaku | (anëtare) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 9. Markelian Koça | (anëtar) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në këtë çështje dhe në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami**, e cila u largua pas trajtimit të çështjes së tretë. Vijimi i mbledhjes drejtohet nga z. Rusi.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.**
- 7. BIRN.**

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Klodian Kurushi:

7.1 “Për një ndryshim në vendimin nr. 375, datë 13.07.2023 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në shkollën e magistraturës, për vitin akademik 2023-2024”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”,

i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Klodian Kurushi.

7.2 “Për një ndryshim në vendimin nr. 390, datë 22.09.2021 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje vazhdojmë me pikën 6 (*i referohet rendit të shpërndarë*) që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës “Për një ndryshim në vendimin nr. 375, datë 13.07.2023 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në shkollën e magistraturës, për vitin akademik 2023-2024”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe “Për një ndryshim në vendimin nr. 390, datë 22.09.2021 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Të nderuar kolegë, unë në mënyrë të shkurtuar po prezantoj relacionin që i bashkëngjitet dy projektvendimeve përkatëse të radhës. Relacioni dhe projektvendimet i referohen çështjeve që ka pasur në ngarkim relatori anëtari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës z. {...}.

Në relatimin e tij ai ka pasur katër çështje të shortuara më parë në kohë, tre çështje që i referohen rasteve të verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve për magistratë që aktualisht janë në vitin e parë në Shkollën e Magistraturës dhe çështja e katërt lidhet me përgatitjen e relacionit të ardhshëm që i referohet rastit të përgatitjes së renditjes së kandidatëve të cilët kandidojnë për një vend të lirë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe kandidatët në këtë rast janë dy gjyqtarë/magjistratë që janë pjesë e relacionit, njëra është zonja {...} dhe kandidatja tjetër është zonja {...}Jemi

në procedurën e hedhjes së çështjes në short për të dyja çështjet e mëdha dhe në këtë pikë ne propozojmë që për çështjen e parë që bën fjalë për përcaktimin e relatorit mbi kandidatët për magistratë që ndjekin studimet e Shkollës së Magjistraturës në vitin e parë, ne propozojmë që për tre kandidatët çështja të hidhet në short ndërmjet tre anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dy anëtarë që janë të përhershëm, unë dhe zoti Alban Toro dhe anëtari i tretë të jetë anëtari zëvendësues zoti Ridvan Hado, për qëllim dhe për efekt të ecurisë së veprimtarisë së Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Ndërsa për çështjen e dytë që bën fjalë për përcaktimin e relatorit në relacionin që do përgatisë për renditjen e kandidatëve për pozicionin e lirë të shpallur në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me qendër në Tiranë, ne propozojmë që në këtë rast mos të hidhet short dhe çështja t'i kalojë drejtpërdrejt për efekte ngarkese, anëtarit të tretë të Komisionit tonë, që është zoti Markelian Koça. Ky është propozimi ynë, e thënë në mënyrë të shkurtuar, pa iu referuar shumë gjatë sepse në mënyrë sintetike ai është i përmendur me shkrim dhe është vënë përpara të gjithë anëtarëve. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, ftoj administratën për të hedhur shortin përkatës.

Procedura e shortit si vijon:

Vendosen në enën e parë shiritat e letrës me emrat e kandidatëve magistratë: znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}.

Vendosen në enën e dytë shiritat me emrat e relatorëve: z. Klodian Kurushi, z. Alban Toro dhe z. Ridvan Hado.

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Kandidati i parë i përzgjedhur është znj. {...}. Për zonjën {...} përzgjidhet relator z. Ridvan Hado.

Kandidati i dytë i përzgjedhur është znj. {...}. Për zonjën {...} përzgjidhet relator

z. Alban Toro.

Kandidati i tretë i përzgjedhur është znj. {...}. Për zonjën {...} përzgjidhet relator z. Klodian Kurushi.

Ilir Rusi: Ka diskutime për mënyrën e hedhjes së shortit dhe përmbajtjen e tij?

(Nuk ka diskutime.)

Hedhim në votim projektvendimin “Për një ndryshim në vendimin nr. 375,[...]”.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për një ndryshim në vendimin nr. 375, datë 13.07.2023 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1.Ndryshimin pjesërisht të pikës 2 të vendimit nr. 375, datë 13.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024”, nënpika 11, si më poshtë:

Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

1.Për kandidaten znj. {...} - relator z. Alban Toro.

2. Ndryshimin pjesërisht të pikës 2 të vendimit nr. 375, datë 13.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “ Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në

formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024”, nënpika 29, si më poshtë:

Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

1. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Ridvan Hado.

3. Ndryshimin pjesërisht të pikës 2 të vendimit nr. 375, datë 13.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024”, nënpika 35, si më poshtë:

Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

1. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Klodian Kurushi.

4. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet secilit prej kandidatëve të përfshirë në pikën 1, 2 dhe 3 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me votimin në lidhje me projektvendimin “Për një ndryshim në vendimin nr. 390, datë 22.09.2021 [...]”.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për një ndryshim në vendimin nr. 390, datë 22.09.2021 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin

nr. 129, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Ndryshimin pjesërisht të pikës 2 të vendimit nr. 390, datë 22.09.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, si më poshtë:

Caktimin e z. Markelian Koça, si relator për këtë procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

2. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet secilit prej kandidatëve të përfshirë në pikën 1 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.01.2024)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2023-2024”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Klodian Kurushi.⁷

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:45 dhe mbaroi në orën 17:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Emona Muçi | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Irena Plaku | (anëtare) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Gentiana Muçaj | (anëtare) |

⁷ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 7-ta sipas rendit të ditës.

9. *Markelian Koça* (anëtar)

10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në këtë çështje dhe në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, e cila u largua pas trajtimit të çështjes së tretë. Vijimi i mbledhjes drejtohet nga z. Rusi.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*

2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*

5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*

6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

7. *BIRN.*

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2023-2024”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Klodian Kurushi.

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje, vazhdojmë me pikën 7 të saj (*i referohet rendit të shpërndarë*) që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2023-2024”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, me relator z. Kurushi. Për më tej fjalën z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Kryetar!

Bashkëlidhur relacionit kemi paraqitur projektvendimin “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2023-2024”. Gjithsej në këtë vit akademik pritet të diplomohen 32 kandidatë. Me paraqitjen e emrave të kandidatëve nga Shkolla e Magjistraturës, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës filloi procedurat e tij, verifikimet, paraqitjen e relacionit përkatës bashkëlidhur projektvendimit për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për kandidatët të cilët më përpara janë kualifikuar po nga ky Këshill dhe u është lejuar e drejta për të vijuar në programin e trajnimit fillestar. Pra bëhet fjalë për kandidatët e vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës.

Po e prezantoj në mënyrë të shkurtuar. Duke qenë 32 kandidatë, përtej emrave që janë të bashkëlidhur këtij projektvendimi dhe këtij relacioni, ne bëjmë edhe dy propozime të tjera. Fillimisht propozojmë që në këtë procedurë shorti që do të hidhet, të mos përfshihet anëtari i ri i Komisionit, z. Markelian Koça, për shkak të asaj shtate që unë e përmenda edhe në relacionin e mëparshëm, por në vend të tij, meqenëse janë 32 kandidatë dhe për të vijuar ecurinë dhe shpejtësinë e procedurave të verifikimit nga komisioni ynë, propozojmë që të përfshihen, përveç anëtarëve të përhershëm që jam unë dhe z. Alban Toro, të përfshihen edhe dy anëtarët zëvendësues, zotërinjtë Ridvan Hado dhe Ilir Rusi. Ky është propozimi i ri që unë mendoj që t’i bashkëngjitet projektvendimit përkatës. Pra në këtë rast ne themi që shorti për verifikimin e 32 kandidatëve të hidhet ndërmjet 4 anëtarëve. Raporti do jetë i tillë: anëtarët e përhershëm të komisionit të kenë secili nga 10 kandidatë, ndërsa anëtarët zëvendësues të komisionit të kenë secili nga 6 kandidatë. Ky është propozimi i parë.

Propozimi i dytë: Në rast pengese ligjore ose papajtueshmërie ligjore të ndonjë prej relatorëve të përfshirë në këtë procedurë verifikimi, për të shmangur mundësinë e hedhjes më pas të çështjes në short, ne propozojmë që çështjet e anëtarit relator gjyqtar t’i kalojnë anëtarit tjetër gjyqtar (pa short) dhe çështjet e anëtarit relator jogjyqtar, t’i kalojnë pa short anëtarit tjetër jogjyqtar të përfshirë në këtë procedurë. Këto janë propozimet

tona. Faleminderit!

Ilir Rusi: Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, meqenëse nuk ka diskutime, të vazhdohet nga administrata me hedhjen e shortit sipas mekanizmit të propozuar nga relatori dhe dakordësuar nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Procedura e shortit si vijon:

Vendosen në enën e parë të qelqit shiritat e letrës me emrat e kandidatëve për magjistratë: 1. znj. {...}; 2. znj. {...}; 3. znj. {...}; 4. znj. {...}; 5. znj. {...}; 6. z. {...}; 7. z. {...}; 8. z. {...}; 9. znj. {...}; 10. znj {...}; 11. znj. {...}; 12. znj. {...}; 13. z. {...}; 14. znj. {...}; 15. znj. {...}; 16. z. {...}; 17. z. {...}; 18. znj. {...}; 19. znj. {...}; 20. znj. {...}; 21. znj. {...}; 22. znj. {...}; 23. znj. {...}; 24. znj. {...}; 25. z. {...}; 26. znj. {...}; 27. z. {...}; 28. z. {...}; 29. znj. {...}; 30. z. {...}; 31. znj. {...}; 32. z. {...}.

Vendosen në enën e dytë të qelqit shiritat e letrës me emrat e relatorëve: z. Klodian Kurushi i cili do të jetë relator për 10 kandidatë, z. Alban Toro i cili do të jetë relator për 10 kandidatë, z. Ridvan Hado i cili do të jetë relator për 6 kandidatë dhe z. Ilir Rusi i cili do të jetë relator për 6 kandidatë.

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Përzgjidhet emri i relatorit, z. Klodian Kurushi. Përzgjidhen emrat e kandidatëve, relator i të cilëve do të jetë z. Kurushi: 9. znj. {...}; 18. znj. {...}; 13. z. {...}; 7. z. {...}; 20. znj. {...}; (në këtë moment ka shkëputje të audios/regjistrimit, kjo pjesë e shortit është zbardhur sipas shënimeve të mbajtura në sallë) 16. z. {...}; 23. znj. {...}; 29. znj. {...}; 8. z. {...}; 21. znj. {...}.

Përzgjidhet emri i relatorit z. Alban Toro. Përzgjidhen emrat e kandidatëve, relator i të cilëve do të jetë z. Alban Toro: 12. znj. {...}; 4. znj. {...}; 19. znj. {...}; 6. z. {...}; 3. znj. {...}; 15. znj. {...}; 10. znj {...}; 17. z. {...}; 26. znj. {...}; 5. znj. {...}.

Përzgjidhet emri i relatorit z. Ridvan Hado. Përzgjidhen emrat e kandidatëve,

relator i të cilëve do të jetë z. Hado: 30. z. {...}; (*rifillon audio/regjistrimi tek emri i përzgjedhur si vijon*) 25. z. {...}; 32. z. {...}; 14. znj. {...}; 1. znj. {...}; 24. znj. {...}.

Përzgjidhet emri i relatorit të fundit z. Ilir Rusi. Përzgjidhen emrat e kandidatëve, relator i të cilëve do të jetë z. Rusi: 31. znj. {...}; 11. znj. {...}; 28. z. {...}; 2. znj. {...}; 22. znj. {...}; 27. z. {...}.

Ilir Rusi: Atëherë, hedhim në votim këtë projektvendim të përditësuar me të dhënat e rezultuara nga shorti, së bashku edhe me relacionin përkatës, propozimet e të cilit u dakordësuan nga anëtarët përgjatë parashtresës së këtij relacioni.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2023-2024”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2023-2024.

II. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

1. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Ridvan Hado;
2. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Ilir Rusi;
3. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Alban Toro;

4. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Alban Toro;
5. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Alban Toro;
6. Për kandidatin z. {...} – relator z. Alban Toro;
7. Për kandidatin z. {...} – relator z. Klodian Kurushi;
8. Për kandidatin z. {...} – relator z. Klodian Kurushi;
9. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Klodian Kurushi;
10. Për kandidaten znj {...} – relator z. Alban Toro;
11. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Ilir Rusi;
12. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Alban Toro;
13. Për kandidatin z. {...} – relator z. Klodian Kurushi;
14. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Ridvan Hado;
15. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Alban Toro;
16. Për kandidatin z. {...} – relator z. Klodian Kurushi;
17. Për kandidatin z. {...} – relator z. Alban Toro;
18. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Klodian Kurushi;
19. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Alban Toro;
20. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Klodian Kurushi;
21. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Klodian Kurushi;
22. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Ilir Rusi;
23. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Klodian Kurushi;
24. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Ridvan Hado;
25. Për kandidatin z. {...} – relator z. Ridvan Hado;
26. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Alban Toro;
27. Për kandidatin z. {...} – relator z. Ilir Rusi;
28. Për kandidatin z. {...} – relator z. Ilir Rusi;
29. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Klodian Kurushi;
30. Për kandidatin z. {...} – relator z. Ridvan Hado;
31. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Ilir Rusi;
32. Për kandidatin z. {...} – relator z. Ridvan Hado.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të

Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.01.2024)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të papërfunduara për shkak të mbarimit të mandatit të anëtares së Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, relatore znj. Emona Muçi.⁸

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:45 dhe mbaroi në orën 17:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 7. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |

⁸ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 8-ta sipas rendit të ditës.

9. *Markelian Koça* (anëtar)

10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në këtë çështje dhe në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, e cila u largua pas trajtimit të çështjes së tretë. Vijimi i mbledhjes drejtohet nga z. Rusi.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*

2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*

5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*

6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

7. *BIRN.*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të papërfunduara për shkak të mbarimit të mandatit të anëtares së Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. {...}*”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, relatore *znj. Emona Muçi*.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 8 të këtij rendi dite (*i referohet rendit të shpërndarë*) që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të papërfunduara për shkak të mbarimit të mandatit të anëtares së Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. {...}*”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Për më tej fjalën relatores *znj. Emona Muçi*.

Emona Muçi: Për të treguar sa më në mënyrë të përmbledhur, koncize, për shkak edhe të orarit dhe të mos zgjatemi, në lidhje me relacionin për miratimin e projektvendimit “Për caktimin e relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të papërfunduara për shkak të mbarimit të mandatit të anëtares së Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. {...}”, rezulton se më datë 12.12.2023 kësaj të fundit i ka përfunduar mandati dhe në proces ka pasur 10 procedura vlerësimi në lidhje me procedurat e vlerësimit etik dhe profesional dhe konkretisht ka pasur 5 procedura gradimi, 2 procedura vlerësimi të përshpejtuar, viti kalendarik 2021-2022, një procedurë vlerësimi 2017-2019 si dhe dy procedura vlerësimi të viteve 2020-2022.

Në zbatim të nenit 89 të Ligjit për Statusin, si dhe vendimeve të Këshillit 263/2019 dhe 159/2023, caktimi i relatorit të ri duhet të bëhet me short midis anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit Etik dhe Profesional, i cili pas vendimit të Këshillit të datës 26.12.2023, përbëhet nga anëtarët znj. Emona Muçi; znj. Irena Plaku dhe znj. Yllka Rupa.

Duke marrë në konsideratë prioritetet në vlerësime dhe shpërndarjen e barabartë të punës mes anëtarëve, Komisioni i propozon Mbledhjes Plenare, organizimin e shortit për përzgjedhjen e relatorit në procedurat e vlerësimit për gjyqtarët: 1. {...}, 2. {...}, 3. Dritan Caka, 4. {...}, 5. {...}, 6. {...}, 7. {...}, 8. {...}, 9. {...}, 10. {...}.

Në procedurën e shortit që do të zhvillohet për përzgjedhjen e relatorit për secilin gjyqtar, do të përfshihen të tre anëtarët e përhershëm të Komisionit, znj. Emona Muçi, znj. Irena Plaku dhe znj. Yllka Rupa, duke pasur parasysh ngarkesën aktuale të punës të anëtarëve të komisionit, si dhe me duke mbajtur parasysh, për qa sa është e mundur, barazinë e shpërndarjes së punës, është vlerësuar që për anëtares Emona Muçi të shorthohen 4 (katër) procedura vlerësimi, për anëtares Yllka Rupa dhe Irena Plaku nga 3 (tre) procedura vlerësimi.

Mënyra se si do procedohet: Në një vazo më vete duhet të vendosen shiritat me letra, me emrin e secilit anëtare, gjithsej 10 shirita (përkatesisht 4:3:3), dhe shiritat e letrës me emrin e gjyqtarëve dhe procesin e vlerësimit të cilëve atyre aktualisht po u kryhet.

Kështu, në përfundim, në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet caktimi i

relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, të papërfunduara nga znj. {...}, konkretisht gjyqtarët: {...}; {...}; {...}; {...} dhe Dritan Caka.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet caktimi i relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar, të papërfunduara nga znj. {...}, periudha e vlerësimit viti kalendarik 2021 dhe 2022, konkretisht gjyqtarët: {...} dhe {...}.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet caktimi i relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të papërfunduara nga znj. {...}, periudha e vlerësimit 2017-2019 dhe 2020-2022, konkretisht gjyqtarët: {...}, {...} dhe {...}.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, ftoj administratën për hedhjen e shortit.

Procedura e shortit si vijon:

Vendosen në enën e qelqit shiritat e letrës me emrat e gjyqtarëve: znj. {...}, znj., {...}, z. {...}, znj. {...}, z. Dritan Caka, z. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}.

Vendosen në enën e qelqit shiritat e letrës me emrat e relatorëve: znj. Irena Plaku (3 shirita letre), znj. Yllka Rupa (3 shirita letre), znj. Emona Muçi (4 shirita letre).

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Gjyqtari i parë i përzgjedhur nga shorti është z. {...}. Relatore e përzgjedhur është znj. Yllka Rupa.

Gjyqtari i dytë i përzgjedhur nga shorti është z. {...}. Relatore e përzgjedhur është znj. Emona Muçi.

Gjyqtari i tretë i përzgjedhur nga shorti është z. {...}. Relatore e përzgjedhur është

znj. Irena Plaku.

Gjyqtari i katërt i përzgjedhur nga shorti është z. {...}. Relatore e përzgjedhur është znj. Irena Plaku.

Gjyqtarja e pestë e përzgjedhur nga shorti është znj. {...}. Relatore e përzgjedhur është znj. Emona Muçi.

Gjyqtarja e gjashtë e përzgjedhur nga shorti është znj. {...}. Relatore e përzgjedhur është znj. Yllka Rupa.

Gjyqtari i shtatë i përzgjedhur nga shorti është z. Dritan Caka. Relatore e përzgjedhur është znj. Irena Plaku.

Gjyqtari i tetë i përzgjedhur nga shorti është z. {...}. Relatore e përzgjedhur është znj. Yllka Rupa.

Gjyqtarja e nëntë e përzgjedhur nga shorti është znj. {...}. Relatore e përzgjedhur është znj. Emona Muçi.

Gjyqtarja e dhjetë e përzgjedhur nga shorti është znj. {...}. Relatore e përzgjedhur është znj. Emona Muçi.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me votimin e projektvendimit me përditësimin e të dhënave të shortit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për caktimin e relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të papërfunduara për shkak të mbarimit të mandatit të anëtares së Këshillit të Lartë

Gjyqësor znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Caktimin e relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, të papërfunduara për shkak të mbarimit të mandatit të anëtares të Këshillit znj. {...}, si më poshtë:

- a) Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Yllka Rupa;
- b) Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Emona Muçi;
- c) Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Irena Plaku;
- d) Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Emona Muçi;
- e) Për gjyqtarin z. Dritan Caka – Relatore znj. Irena Plaku.

2. Caktimin e relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar, periudha e vlerësimit viti kalendarik 2021 dhe 2022, të papërfunduara për shkak të mbarimit të mandatit të anëtares së Këshillit znj. {...}, si më poshtë:

- a) Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Irena Plaku;
- b) Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Yllka Rupa.

3. Caktimin e relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit 2017-2019 dhe 2020-2022, të papërfunduara për shkak të mbarimit të mandatit të anëtares së Këshillit znj. {...}, si më poshtë:

- a) Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Emona Muçi;
- b) Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Yllka Rupa;
- c) Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Emona Muçi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.01.2024)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 1/2021, të filluar ndaj magjistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor, relator z. Ilir Rusi.⁹

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:45 dhe mbaroi në orën 17:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Emona Muçi | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Irena Plaku | (anëtare) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Gentiana Muçaj | (anëtare) |

⁹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 9-ta sipas rendit të ditës.

9. *Markelian Koça* (anëtar)

10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në këtë çështje dhe në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, e cila u largua pas trajtimit të çështjes së tretë. Vijimi i mbledhjes drejtohet nga z. Rusi.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*

2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*

5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*

6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

7. *BIRN.*

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 1/2021, të filluar ndaj magjistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor, relator z. Ilir Rusi.

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me pikën 9 të këtij rendi dite (*i referohet rendit të shpërndarë*) që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 1/2021, të filluar ndaj magjistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni Disiplinor dhe relator jam unë z. Rusi.

Më datë 22.04.2021, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, është depozituar kërkesa e

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...}, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Me vendimin nr. 175, datë 26.04.2021, mbi bazën e shortit, Këshilli ka vendosur caktimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor z. {...}, në cilësinë e relatorit të çështjes.

Me vendimin nr. 463, datë 11.10.2021, Këshilli ka vendosur pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistrates znj. {...}, deri në marrjen formë të prerë të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me të cilin është disponuar dhënia e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” sipas përcaktimeve ligjore përkatëse.

Me vendimin nr. 581, datë 13.12.2021 (*ka një lapsus kur citohet data*) të këtij Këshilli, ka vendosur deklarin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. {...}.

Në vijim, është bërë formatimi i ri i këtij Komisioni e për më tej ka vendosur “Caktimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor, z. {...}, në cilësinë e relatorit të procedimit disiplinor”, me vendimin nr. 11, datë 17.01.2022.

Me vendimin e nr. 22, datë 24.02.2022 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr. 77 datë 02.03.2022 ka vendosur deklarin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. {...}.

Në mbështetje të bazës ligjore përkatëse është bërë zëvendësimi i këtij anëtari për shkak të mbarimit mandatit, me mua z. Ilir Rusi.

Me vendimin nr. 127, datë 04.04.2022 Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbi propozimin e Komisionit Disiplinor, pas hedhjes së shortit, ka vendosur: Caktimin si relator z. {...}.

Me vendimin nr. 738, datë 12.12.2023, Këshilli, ka vendosur deklarin e mbarimit të mandatit të z. {...}.

Në vijim, është bërë formatimi i ri i Komisionit Disiplinor me vendimin nr. 742, datë 26.12.2023.

Ndodhur në këto situata, kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ka iniciuar një procedurë individuale administrative e cila ka lidhje me statusin profesional të magjistratit në fjalë në referim të nenit 63 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, nga ana e Këshillit duhet të procedohet me hedhjen e shortit për caktimin e relatorit të ri të çështjes dhe do caktohet

një nga anëtarët.

Nga sa u parashtrua, Komisioni Disiplinor, bazuar në nenin 63 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i propozon Mbledhjes Plenare, zhvillimin e procedurës për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 1/2021, të filluar ndaj magjistrates, znj. {...}.

Lidhur me procedurën e shortit, në kushtet kur, anëtari i Komisionit Disiplinor z. Ridvan Hado, ka deklaruar me shkresën nr. {...} prot., datë 17.01.2022 përpara Mbledhjes Plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, papajtueshmërinë për pjesëmarrje në procedimin disiplinor të magjistrates {...}, Komisioni Disiplinor propozon që në short të përfshihen dy anëtarët e përhershëm të këtij komisioni, që janë znj. Gentiana Muçaj dhe unë z. Ilir Rusi, si dhe anëtari zëvendësues Markelian Koça, në referim të bazës ligjore përkatëse.

Projektvendimi i propozuar është i strukturuar në 2 pika.

Pika 1 e projektvendimit bën fjalë për caktimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor, pas hedhjes së shortit

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistrates znj. {...}, sipas kërkesave përkatëse ligjore.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet hyrja e tij në fuqi, konkretisht në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ilir Rusi: Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, ftoj administratën në hedhjen e shortit.

Procedura e shortit si vijon:

Futen në enën e qelqit shiritat e letrës me emrat e anëtarëve: znj. Gentiana Muçaj, z. Ilir Rusi, z. Markelian Koça.

Procedura e përzgjedhjes:

Relator për procedimin disiplinor nr. 1/2021 përzgjidhet relator z. Markelian Koça.

Ilir Rusi: Faleminderit administrata.

Ka diskutime pas hedhjes së shortit?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit të përditësuar me të dhënat që rezultuan nga shorti. Vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 1/2021, të filluar ndaj magjstrates znj. {...}, me funksion gjyqtare në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Caktimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor, z. Markelian Koça në cilësinë e relatorit të procedimit disiplinor nr. 1/2021, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndaj magjstrates, znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

2. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjstrates, znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e

qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.01.2024)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtarës znj. {...} në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Klodian Kurushi.¹⁰

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:45 dhe mbaroi në orën 17:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |

¹⁰ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 10-ta sipas rendit të ditës.

8. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
9. *Markelian Koça* (anëtar)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në këtë çështje dhe në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, e cila u largua pas trajtimit të çështjes së tretë. Vijimi i mbledhjes drejtohet nga z. Rusi.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
7. *BIRN.*

RENDI I DITËS:

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtarës znj. {...} në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Klodian Kurushi.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 10 të këtij rendi dite (*i referohet rendit të shpërndarë*) që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtarës znj. {...} në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të

Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Atëherë, bashkëlidhur po paraqes relacionin e radhës që ka për objekt projektvendimin “Për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.

Me vendimin e datës 05.07.2019 Këshilli i Lartë Gjyqësor shpalli kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtareve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit:

Brenda afatit të kandidimit në këtë pozicion kandidoi dhe zonja {...}, gjyqtare në atë kohë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Në përfundim të procedurës së komandimit, me vendimin nr. 23, datë 20.01.2020 Këshilli vendosi (pra pasi i përfundoi afati i parë kohor dhe kërkesën për zgjatje të afatit të komandimit): Periudha e komandimit për zonjën {...} fillimisht ishte 2 vjet, pra pranoi kërkesën e saj, komandimin e gjyqtares në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin në Njësinë e Vlerësimit Profesional. Fillimisht periudha e komandimit ishte dy vjet dhe filloi nga data 21.01.2020.

Më pas, në përfundim të afatit të komandimit, me kërkesë të zonjës {...}, Këshilli me vendimin nr. 28, datë 20.01.2022 vendosi përsëritjen e komandimit të gjyqtares në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Etik dhe Profesional edhe për një afat dyvjeçar. 2. Efektet juridike të vendimit fillojnë më datë 21.01.2022.”

Aktualisht afati i periudhës së komandimit të znj. {...} është duke përfunduar, konkretisht më datë 21.01.2024 dhe nuk rezulton të ketë shfaqur vullnet për përsëritjen e afatit komandimit.

Në këto kushte, ne si Komision përgatitëm relacionin dhe i propozojmë Këshillit të Lartë Gjyqësor projektvendimin përkatës, i cili përbëhet nga pikat e mëposhtme:

Pika e parë është: 1. Përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit

Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor në fund të afatit të komandimit, më datë 21.01.2024.

2. Kthimin e gjyqtares znj. {...} në pozicionin e mëparshëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së komanduar sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si edhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (vend të cilin kjo gjyqtare ka pozicionin e përhershëm).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit për vëmendjen.

Këto janë propozimet tona.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor në fund të afatit të komandimit, më datë 21.01.2024.

2. Kthimin e gjyqtares znj. {...} në pozicionin e mëparshëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së komanduar znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si edhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 11 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.01.2024)

Pika 12 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e programit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2024”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, relatore znj. Irena Plaku.¹¹

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:45 dhe mbaroi në orën 17:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 7. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |

¹¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 11-ta sipas rendit të ditës.

9. *Markelian Koça* (anëtar)

10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në këtë çështje dhe në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, e cila u largua pas trajtimit të çështjes së tretë. Vijimi i mbledhjes drejtohet nga z. Rusi.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*

2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*

5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*

6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

7. *BIRN.*

RENDI I DITËS:

12. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e programit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2024”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, relatore *znj. Irena Plaku*.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 11 të këtij rendi dite (*i referohet rendit të shpërndarë*) që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e programit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2024”, për të cilin është përgatitur materiali përkatës nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Për më tej fjalën relatores *znj. Plaku*.

Irena Plaku: Faleminderit!

Po ju parashtoj në mënyrë të përmbledhur edhe unë relacionin për programin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2024, i cili i është dërguar paraprakisht anëtarëve.

Relacioni përbëhet nga disa pika ku në pikën e parë është paraqitur gjendja e procedurës së vlerësimit të filluar deri tani, konkretisht janë parashikuar vlerësimet e zakonshme gradimet dhe vlerësimet e përshpejtuara.

Në procedurën e gradimit janë aktualisht 36 gjyqtarë, 4 për të cilët ka përfunduar dhe i janë përcjellë plenares.

Janë 25 gjyqtarë të cilët janë në vlerësim 3-vjeçar 2017-2019 dhe 2020-2022 të cilët këto kanë qenë në programin e mëparshëm; Si dhe janë në vlerësim të përshpejtuara, konkretisht për vitin 2019, 2021 dhe 2022 – 7 gjyqtarë, si dhe vlerësimet e dy gjyqtarëve që janë në Këshill.

Në pikën e dytë të relacionit është përcaktuar lista e gjyqtarëve për periudhën e vlerësimit. Edhe në këtë program vlerësimi është menduar që pasur parasysh ngarkesën e gjyqtarëve por edhe pasur parasysh procedurat të cilat janë hapur për ngritjen në detyrë apo për lëvizjet paralele kur gjyqtarë që kanë aplikuar në këto procedura kanë filluar vlerësimet e përshpejtuara, të mos bëhen vlerësime 5-vjeçare për faktin se kush gjyqtar ka aplikuar për ngritje në detyrë i ka filluar një vlerësim i përshpejtuar dhe nuk mund t'i bëhet një vlerësim tjetër.

Është bërë një përshkrim i të gjitha procedurave të hapura dhe vlerësimeve të cilat kanë filluar apo kanë përfunduar nga ana e Këshillit, duke konkluduar që të bëhet një vlerësim trevjeçar për të gjithë ata gjyqtarë që nuk kanë vlerësim deri... qëllimi është që të gjithë gjyqtarët që nuk kanë vlerësim të mëparshëm të përfshihen në periudhën e vlerësimit trevjeçar e cila përkon në fakt me periudhën e vlerësimit 01.01.2020 deri 31.12.2022 si dhe një periudhë tjetër që përfshin 2021-2023 pasi në këtë program vlerësimi janë përfshirë të gjithë gjyqtarët të cilët e kanë mbushur afatin trevjeçar në vitin 2022 por edhe në vitin 2023, pasur parasysh që ligji parashikon që në program të futen të gjithë gjyqtarët të cilët në vitin kur miratohet ka mbushur periudhën trevjeçare. Gjithashtu është konstatuar nga të gjithë programet e vlerësimit të mëparshëm ku zonja {...}, megjithëse ishte përfshirë në një program të vlerësimit 2021, nuk kishte filluar

asnjëherë procedura e vlerësimit për shkak se është shkarkuar me vendim të KPK-së, e cila më pas është konfirmuar me vendim të KPA-së të vitit 2023 dhe duke qenë se nuk kishte vlerësim të zakonshëm trevjeçar, pasur parasysh edhe në fakt të gjithë vitin e saj të cilin është emëruar; gjithashtu është konstatuar që në këtë program nuk ishte futur edhe zoti {...} i cili nuk ka një vlerësim të mëparshëm dhe ndër të tjera nuk mund t'i bëhet një vlerësim i mëparshëm edhe periudha e gradimit, duke qenë se nga ana e Këshillit është vendosur mosfillimi i procedurës për shkak se është emëruar në fund të vitit 2016.

Programi i vlerësimit është ndarë në tre lista, pasur parasysh periudhat e ndryshme të vlerësimit, konkretisht në listën e parë është paraqitur periudha e vlerësimit 2017-2019, ku konkretisht janë {...}, {...} dhe ku janë parashikuar edhe arsyet pse këto janë përfshirë në këtë listë.

Në listën e dytë janë përfshirë të gjithë gjyqtarët të cilët janë emëruar në datë 09.01.2020 dhe kanë plotësuar tre vite punë në 2022. Në këtë propozim është shtuar edhe znj. {...} e cila nuk ishte përfshirë në programin e vlerësimit për shkak se kishte qenë e komanduar në vitin 2023.

Ndërsa në listën e tretë janë përfshirë të gjithë gjyqtarët të cilët janë emëruar në datë 20.10.2020 dhe për këta është menduar që të fillojë periudha e vlerësimit 2021-2023 për shkak se ligji ka parashikuar që periudhat e vlerësimit fillojnë në 1 janar dhe përfundojnë në 31 janar të vitit përkatës dhe për këtë është menduar që të fillojë në 1.01.2021 deri në 31.12.2023. Nga kjo listë në fakt janë përjashtuar dy gjyqtarë: znj. {...} për shkak se nuk ka më pak se një vit periudhë përvojë pune për shkak se nga ana e Këshillit është miratuar leja e papaguar për arsye familjare e cila nuk njihet edhe si vjetërsi në punë, si dhe zonja {...} për shkak se është komanduar në Këshill në muajin qershor (me sa mbaj mend) të vitit 2022 dhe nuk e kishte plotësuar një vit pune eksperiencë në gjykatën e rrethit gjyqësor Fier. Si dhe për shkak se Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 159, të datës 05.04.2023 ka parashikuar se periudha e vlerësimit është periudha që përfshin të gjithë komandimin dhe përfundon deri në momentin që i përfundon komandimi. Komandimi i zonjës {...} përfundon në 2024 (në qershor 2024) dhe për këtë arsye do përfshihet në një program tjetër vlerësimi.

Ndër të tjera, veç listës së programit të vlerësimit (listat 1, 2, 3), ky program

vlerësimi përmban edhe gradimet e gjyqtarëve të cilët do të konfirmohen gjatë kësaj kohe, pasi të administrohen nga KPK-ja dosjet përkatëse. Ndër të tjera do përfshihen edhe tre gjyqtarë të cilët kanë qenë anëtarë të Këshillit dhe që i ka përfunduar mandati në 12.12.2023, si dhe vlerësimet e përshpejtuara të detyruara për vitin 2022 dhe 2023 apo programe të tjera të cilat në rast se nga ana e Këshillit do të hapen procedurat e tjera të ngritjes në detyrë apo lëvizjes paralele.

Si një prioritet planifikimi është parashikuar që të kryhen me përparësi të gjitha vlerësimet në procedurë të përshpejtuar të detyruar sipas nenit 22 dhe 23/b; gradimin e gjyqtarëve të cilët kanë kaluar me sukses procesin e vlerësimit; vlerësimin e gjyqtarëve të komanduar si ndihmës magjistrat apo atyre të komanduar në Këshill në rast aplikimi të tyre për ngritje në detyrë apo për lëvizje paralele, sepse sipas rregullores 154 është parashikuar që në momentin që ata aplikojnë, periudha e vlerësimit do të jetë nga dita e komandimit deri në ditën që kanë aplikuar; si dhe vlerësimi normal për vitin 1.01.2017 – 31.12.2019; vlerësimin normal për periudhën trevjeçare 01.01.2020 (*lapsus viti që citon znj. Plaku - 2022*) – 31.12.2022 dhe 01.01.2021 – 31.12.2023 (sipas listës që janë parashikuar në relacion).

Në qoftë se keni pyetje për sqarime të mëtejshme, që mos të zgjatem. Ndonjë diskutim?

Faleminderit!

Ilir Rusi: Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për miratimin e programit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2024”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1.Miratimin e programit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2024, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi e pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 12 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.01.2024)

Pika 13 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lire të shpallur me vendimin nr. 11, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Klodian Kurushi.¹²

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:45 dhe mbaroi në orën 17:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |

¹² Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 12-ta sipas rendit të ditës.

8. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
9. *Markelian Koça* (anëtar)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në këtë çështje dhe në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, e cila u largua pas trajtimit të çështjes së tretë. Vijimi i mbledhjes drejtohet nga z. Rusi.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jastë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
7. *BIRN.*

RENDI I DITËS:

13. Shqyrtim i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lire të shpallur me vendimin nr. 11, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Klodian Kurushi.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 12 të kësaj mbledhjeje (*i referohet rendit të shpërndarë*) që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lire të shpallur me vendimin nr. 11, datë

18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatores z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Atëherë, me vendimin e datës 18.01.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi katërmbëdhjetë procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimin nr. 11, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Afati i kandidimit për këto procedura të lëvizjes paralele si më lart u përcaktua deri më datë 01.02.2023.

Brenda afatit të kandidimit për këtë pozicion që përmenda më lart, fillimisht kandiduan gjithsej 7(shtatë) kandidatë, sipas tabelës që është pjesë integrale e relacionit.

Më tej, pas përfundimit të afatit të kandidimit në procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për tre procedurat në proces, referuar pikës 9 të vendimit 11/2023 Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr.77, datë 13.02.2023, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose që mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele për pozicionin 11. Në këtë listë u përfshinë këta kandidatë: z. {...}, z. {...}, z. {...}.

Në vijim, me vendimin nr. 115, datë 13.03.2023, Këshilli vendosi: “I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura ndër të tjera me vendimet nr. 11...;..datë 18.01.2023 dhe caktimin e relatorit përkatës në këto procedura.

Sipas pikës 7, të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016, në një procedurë lëvizje paralele për një pozicion të lirë, Këshilli i Lartë Gjyqësor bën renditjen e kandidatëve që përmbushin kriteret, renditje kjo që bëhet në funksion të përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, i cili do të duhet të transferohet nëpërmjet mekanizmit të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit, të lëvizjes paralele, Këshilli realizoi procedurat e verifikimit të plotësimit nga 2 (dy) prej

kandidatëve të kritereve të mëposhtme (pasi z. {...} u tërhoq nga kandidimi i tij për pozicionet e shpallura me vendimet nr.11, nr. 12 dhe nr. 13 datë 18.01.2023, pra paraqiti kërkesë për t'u tërhequr nga procedurat e kandidimit).

Më tej Këshilli vijoi procedurat për verifikimin e kritereve formale që janë përvoja profesionale, mospasja e masës disiplinore në fuqi, si dhe mosqenia në situatën e papajtueshmërisë ambientale.

Kandidatët e kualifikuar sipas pozicioneve që aplikuan, ishin z. {...}, që ushtron funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë (aktualisht) si dhe z. {...} që aktualisht ushtron funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Me kualifikimin e kandidatëve në pozicionin respektiv nr. 11, bazuar në pikën 75 Vendimit të Këshillit nr. 320, datë 19.02.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, Këshilli me vendimin nr. 294, datë 30.05.2023, vendosi fillimin e procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë edhe për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 11.

Më datë 30.05.2023, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 75 e vijuese të Vendimit të Këshillit “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, kandidatët e kualifikuar u njoftuan për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile.

Në zbatim të pikës 106, të vendimit të Këshillit 320/2020, relatori administroi dokumentacionin përkatës për kandidatët e kualifikuar, që gjendeshin në dosjet personale apo në praktikën dokumentare të procedurave të verifikimit të plotësimit të kritereve të kandidimit.

Konkretisht, lidhur me vlerësimet etike dhe profesionale, për kandidatët u konstatua se:

Për kandidatin z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, rezultoi që ai kishte dy vlerësime etike–profesionale, për periudhën 2013-2016 dhe një vlerësim të dy-të 3-vjeçar, për periudhën e vlerësimit 2017-2019.

Për kandidatin z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës të Juridiksionit të

Përgjithshëm Dibër, gradimi nuk mund të realizohet nga Këshilli, pasi Komisionit i Pavarur i Kualifikimit me vendimin e ndërmjetëm nr. 5, datë 24.07.2020 i ka dhënë atij masën disiplinore të pezullimit nga detyra për një periudhë 1-vjeçare me detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës.

Ky vendim i paankimueshëm e bëri të pamundur realizimin e procesit të vlerësimit me qëllim gradimi për gjyqtarin. Ky vlerësim i KPK-së, për efekt të niveleve të vlerësimit të përcaktuar në nenin 78 pika 1 të Ligjit “Për Statusin”, barazohet me nivelin “*e pamjaftueshëm*”. Nga ana tjetër, vlerësimi i fundit etik-profesional që ky gjyqtar rezulton ai që ka pasur para hyrjes në fuqi të Ligjit “Për Statusin”, dhe është ai i miratuar me vendimin nr. {...}, datë 13.11.2015 të ish-KLD-së për periudhën e vlerësimit 2007-2009 në nivelin “*shumë mirë*” në atë kohë.

Pra këto ishin dhe dy vlerësimet e të dy kandidatëve: z. {...} ka dy vlerësimi, vlerësimi i parë ai 2013-2016, shumë mirë me 365 pikë dhe vlerësimi i dytë i Këshillit është shumë mirë për periudhën 2017-2019 me 371 pikë. Ndërkohë për zotin {...}, vlerësimi i parë është ai i KLD-së nr. {...}, datë 13.11.2015, ku kandidati është vlerësuar për periudhën 2007-2009 në vlerësimin e përgjithshëm “shumë mirë”. Sipas vendimit të Këshillit Pedagogjik si dhe Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, me vendimin nr. 20, datë 15.7.2021, i konfirmuar edhe nga vendimi i KPK, datë 16.09.2021 konstatohet se subjekti i rivlerësimit {...} ka arritur rezultatin “mirë”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit që unë e përmenda më lart, në përputhje me Kreun IV, të Vendimit 320/2020, relatori realizoi renditjen e kandidatëve për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur nga Këshilli për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë.

Lidhur me renditjen e kandidatëve u mbajtën në konsideratë pika 7, e nenit 43 të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “7. Këshillat shqyrtojnë kandidimet dhe rendisin magistratët që përmbushin kërkesat, sipas rezultateve të poshtëshënuara: [...]”.

Në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 11, datë 18.01.2023, u përfshinë dy kandidatë, konkretisht: z. {...} dhe z. {...}.

Për renditjen e kandidatëve, fillimisht u ndoq hapi i parë i renditjes, ku për secilin

kandidat u bë një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 43, pika 7, germa “a”, të Ligjit për Statusin, si dhe të detajuara në Seksionin B.1, Kreu VI, të Vendimit 320/2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Referuar kriterit të parë të renditjes, pra atij të “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, për kandidatët u konstatua se:

Për kandidatin z. {...}, sipas Vendimit të KLGJ, nr. 306, datë 06.06.2023 kandidati është vlerësuar për periudhën 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”, duke grumbulluar në total 365 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional” të miratuar me këtë vendim. Vendim i cili ka marrë formë të prerë.

Vlerësimi i dytë, Sipas vendimit të Këshillit nr. 708, datë 04.12.2023, kandidati është vlerësuar për periudhën e vlerësimit 2017-2019, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”, duke grumbulluar në total 371 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional” të miratuar me këtë vendim.

Për kandidatin z. {...}, sipas vendimit të KLD nr. 110/2 datë 13.11.2015, kandidati është vlerësuar për periudhën 2007-2009, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”. Sipas pikës 117 germa “b” të vendimit nr. 320/2020 të KLGJ-së konvertimi i nivelit të vlerësimit sipas sistemeve të mëparshme të vlerësimit etik dhe profesional, me ato sipas sistemit të vlerësimit në fuqi (Ligji për Statusin) realizohet sipas rendit ku niveli i vlerësimit “shumë mirë”, sipas sistemit të mëparshëm të vlerësimit etik dhe profesional barazohet me nivelin e vlerësimit “shkëlqyeshëm”, sipas sistemit të vlerësimit etik dhe profesional në fuqi (Ligji për Statusin). Në këtë rast vlerësimi etik dhe profesional i vendosur nga KLD për këtë kandidat në nivelin “shumë mirë” konvertohet në nivelin “shkëlqyeshëm” nga Këshilli mbështetur në pikën 117 germa “b” të vendimit nr. 320/2020 të KLGJ-së.

Vlerësimi i dytë, sipas vendimit të Këshilli Pedagogjik si dhe Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, datë 15.07.2021, konstatohet se subjekti i rivlerësimit {...} ka arritur nivelin “mirë”. Ky rezultat përfaqëson edhe nivelin e vlerësimit “Mirë” që ka marrë kandidati për periudhën e dytë të vlerësimit etik dhe profesional që përfshin vitin akademik në Shkollën e Magjistraturës 2020 – 2021.

Nga zbatimi i kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, rezultoi që kandidati z. {...}, të ketë “Shumë mirë” dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale të kryera nga Këshilli për efekt të gradimit dhe vlerësimit periodik 2017-2019. Kurse kandidati z. {...} dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale i ka “Shumë mirë” – vlerësim i bërë nga ish-KLD për periudhën e vlerësimit 2007-2009 i konvertuar në “Shkëlqyeshëm” dhe “Mirë” gjatë vitit 2020-2021 nga Shkolla e Magjistraturës, vendimmartje kjo e detyrueshme pas vlerësimit të KPK-së, e cila konkludoi se nuk arrin nivelin minimal profesional për periudhën 2006-2016.

Nivelet e vlerësimit sipas pikës 1, të nenit 78, të Ligjit për Statusin janë sipas këtyre niveleve: a) "Shkëlqyeshëm", në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi shumë të larta; b) "Shumë mirë", në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi mbi mesataren; c) "Mirë", në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi mesatare; ç) "Mjaftueshëm", në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi nën mesataren. d) "I pamjaftueshëm", në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi të dobët. Nga vlerësimi krahasues i niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale për kandidatët, duke pasur parasysh pesë nivelet e vlerësimit, identifikohet kandidati me rezultatet më të larta. Për pasojë, renditja e kandidatëve mund të bëhet sipas kësaj përparësie, pra i referohemi niveleve të vlerësimit.

Renditja e kandidatëve bëhet duke krahasuar të dy nivelet e vlerësimeve për secilin prej tyre. Vlen të theksojmë se në përcaktimin e renditjes në këtë rast asnjë nga nivelet e vlerësimit për secilin kandidat nuk përputhet me njëri – tjetrin. Kandidati z. {...} është vlerësuar me konvertim në nivelin “Shkëlqyeshëm” për periudhën e vlerësimit etik dhe profesional në vitet 2007 – 2009 dhe nivelin “Mirë” nga Shkolla e Magjistraturës për vitin akademik 2020 – 2021. Kandidati z. {...} është vlerësuar në nivelin “Shumë mirë” nga Këshilli për periudhën vlerësimit etik dhe profesional (gradimi) për vitet 2013 – 2016 dhe sërish në nivelin “Shumë mirë” nga Këshilli për periudhën e vlerësimit etik dhe profesional në vitet 2017 – 2019.

Ndodhur përpara situatës ku asnjë nivel vlerësimi për kandidatët nuk është i njëjtë, renditja e kandidatëve mbështetur në nenin 43 germa “a” dhe në pikën 79 të

vendimit të KLGJ nr. 320/2020 do të bazohet në vlerësimet krahasuese të niveleve të dy vlerësimeve të marra së bashku për secilin kandidat. Dy nivelet e vlerësimit etik dhe profesional për kandidatin z. {...} janë “Shkëlqyeshëm” vlerësimi i parë dhe “Mirë” vlerësimi i dytë. Rezultati i vlerësimit mesatar i të dy niveleve të vlerësimit për kandidatin z. {...} është “Shumë mirë”.

Dy nivelet e vlerësimit etik dhe profesional për kandidatin e dytë z. {...} janë “Shumë mirë” vlerësimi i parë dhe “Shumë mirë” vlerësimi i dytë. Rezultati i vlerësimit mesatar i të dy niveleve të vlerësimit për kandidatin z. {...} është “Shumë mirë”.

Meqenëse të dy kandidatët kanë rezultate të njëjta në vlerësimin mesatar të të dy niveleve të vlerësimit, për renditjen e tyre në këtë rast zbatohen përparësitë e parashikuara nga pika 81 e vendimit të KLGJ-së nr. 320/2020. Sipas pikës 81 të këtij vendimi kur rezultatet janë të njëjta në nivele vlerësimi, zbatohen për më tej përparësitë sipas radhës si vijon: a) “niveli i vlerësimi i fundit” – Sipas kësaj përparësie kandidati me nivelin më të lartë të vlerësimit të fundit etik dhe profesional, renditet më lart; b) “përvoja si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit ose i anëtar i Këshillit” – Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka një nga këto përvoja, renditet më lart; c) “kohëzgjatja e përvojës si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemë delegimi ose si anëtar i Këshillit” – Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka më shumë nga këto përvoja renditet më lart; ç) “shumëllojshmëria e përvojave si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit ose si anëtar i Këshillit” – Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka më shumë nga këto përvoja renditet më lart.

Në këtë rast kur rezultatet në vlerësimin mesatar të të dy niveleve të vlerësimit janë të njëjta për renditjen e kandidatëve zbatohet përparësia e parashikuar nga pika 81 germa “a” e vendimit të KLGJ-së nr. 320/2020 sipas të cilit për të renditur kandidatët përparësi merr kandidati me nivelin më të lartë të vlerësimit të fundit etik dhe profesional. Për kandidatin z. {...} niveli i vlerësimit të fundit është niveli “Mirë” që përfshin periudhën e vlerësimit të viti akademik 2020 – 2021 të bërë nga Shkolla e Magjistraturës. Për kandidatin z. {...} niveli i vlerësimit të fundit etik dhe profesional është niveli “Shumë mirë” që përfshin periudhën e vlerësimit për vitet 2017 – 2019 të bërë nga Këshilli.

Mbi këtë bazë arrihet të bëhet renditja e kandidatëve, për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 11, datë 18.01.2023, ku më lart renditet kandidati z. {...} me vlerësimin e fundit etik dhe profesional në nivelin “Shumë mirë”, ndërsa kandidati tjetër z. {...} renditet pas tij për shkak të vlerësimit të fundit të tij në nivelin “Mirë”. Meqenëse pas këtij hapi arrihet të përzgjidhet kandidati që renditet i pari referuar kriterëve të nivelit të vlerësimit, vijimi i hapave të tjerë të renditjes është i panevojshëm.

Për rrjedhojë, renditja e kandidatëve për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 11, datë 18.01.2023, rezulton si më poshtë:

- 1) Z. {...};
- 2) Z. {...}.

Bazuar në sa përcaktohet në pikat 23-29 të këtij relacioni, sikundër edhe në rezultatin e renditjes sipas pikës 30 të tij, relatori përgatiti projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 11 datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Projektvendimi “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 11 datë 18.01.2023” u shqyrtua nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në mbledhjen e datës 26.12.2023, sikurse përcaktohet në Seksionin DH, Kreu VI, të vendimit 320/2020.

Projektvendimi është i strukturuar në 3 pika.

Sipas pikës së parë të projektvendimit, Këshillit i propozohet të miratojë renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 11, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

- 1) Z. {...};
- 2) Z. {...}.

Në pikën 2 të projektvendimit, përcaktohet se një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve z. {...} dhe z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr.

115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Së fundi, në projektvendimin përcaktohet se ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 11, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 11, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Z. {...};

2. Z. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve z. {...} dhe z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 13 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.01.2024)

Pika 14 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, të datave: 05.10.2023, 11.10.2023, 12.10.2023, 18.10.2023, 19.10.2023, 24.10.2023, 26.10.2023, 02.11.2023, 03.11.2023, 08.11.2023, 14.11.2023, 15.11.2023, 21.11.2023, 30.11.2023.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:45 dhe mbaroi në orën 17:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
2. *Klodian Kurushi* (anëtar)
3. *Fatmira Luli* (anëtare)
4. *Emona Muçi* (anëtare)
5. *Ridvan Hado* (anëtar)
6. *Irena Plaku* (anëtare)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
9. *Markelian Koça* (anëtar)

Shënim: Nuk mori pjesë në këtë çështje dhe në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami**, e cila u largua pas trajtimit të çështjes së tretë. Vijimi i mbledhjes drejtohet nga z. Rusi.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.**
- 7. BIRN.**

RENDI I DITËS:

14. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, të datave: 05.10.2023, 11.10.2023, 12.10.2023, 18.10.2023, 19.10.2023, 24.10.2023, 26.10.2023, 02.11.2023, 03.11.2023, 08.11.2023, 14.11.2023, 15.11.2023, 21.11.2023, 30.11.2023.

Ilir Rusi: Në vijim po vazhdojmë me shqyrtimin e pikës 14 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, të datave: 05.10.2023, 11.10.2023, 12.10.2023, 18.10.2023, 19.10.2023, 24.10.2023, 26.10.2023, 02.11.2023, 03.11.2023, 08.11.2023, 14.11.2023, 15.11.2023, 21.11.2023, 30.11.2023.

Duke iu referuar kohës së zhvillimit të këtyre mbledhjeve dhe mbajtjes së këtyre procesverbaleve, rezulton që një pjesë e anëtarëve të ardhur rishtazi nuk ka qenë pjesë e

këtyre mbledhjeve. Kështu që edhe në një komunikim paraprak që kemi pasur, tre anëtarët e ardhur rishtazi që janë prezent në këtë mbledhje, zonja Muçaj, zoti Koça dhe zonja Muçi nuk do marrin pjesë në këtë votim.

Për më tej votimi do të kryhet nga anëtarët e tjerë prezent të cilët sipas kuorumit jemi 7.

Vazhdojmë në miratimin e projektvendimit përkatës

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

(Anëtarët e rinj nuk marrin pjesë në votim, pasi ata kanë qenë pjesë e Këshillit nga data 12.12.2023 e në vijim.)

Vendim “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 05.10.2023, 11.10.2023, 12.10.2023, 18.10.2023, 19.10.2023, 24.10.2023, 26.10.2023, 02.11.2023, 03.11.2023, 08.11.2023, 14.11.2023, 15.11.2023, 21.11.2023 dhe 30.11.2023.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 14 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.01.2024)

Pika 15 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).¹³

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:45 dhe mbaroi në orën 17:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Emona Muçi | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Irena Plaku | (anëtare) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Gentiana Muçaj | (anëtare) |

¹³ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

9. *Markelian Koça* (anëtar)

10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në këtë çështje dhe në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, e cila u largua pas trajtimit të çështjes së tretë. Vijimi i mbledhjes drejtohet nga z. Rusi.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*

2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*

5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*

6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

7. *BIRN.*

RENDI I DITËS:

15. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Çështja e fundit e rendit të ditës lidhet me caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionet në mënyrë të përhershme. Zoti Rusi thekson që materiali është i përditësuar.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, z. Klodian Kurushi për të relatuar relacionin Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Zoti Kurushi merr fjalën dhe parashtron se:

Deri më datë 17.01.2024, pranë KLGJ-së, janë regjistruar për trajtim dy kërkesa për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçantë, të Zëvendëskryetares së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, sipas të dhënave të mëposhtme: (lexohen të dhënat e çështjeve sipas tabelës në relacion).

Kërkohej caktimi i 1 (një) gjyqtari për plotësimin e trupit gjykues në gjykimin e dosjes penale në ngarkim të të pandehurve {...} etj, dosje e kthyer për rigjykim nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Janë një sërë gjyqtarësh që për shkak të pengesave ligjore nuk mund ta shqyrtojnë çështjen pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Një pjesë tjetër e gjyqtarëve janë caktuar po nga Këshilli për shkak të ezaurimit të trupit gjykues në këtë gjykatë.

Në çështjen e dytë penale, është një dosje e ndarë nga procedimi penal 75/2022. Në relacion janë përmendur çështjet për të cilat janë konsumuar gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar si dhe gjyqtarët e tjerë që janë përfshirë si pasojë e procedimeve të lidhura në shqyrtimin e kërkesave apo çështjeve të tjera të ndara nga çështja e themelit të parë.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

1. Për çështjen me numrin rendor 1 në tabelë, gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jenë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

2. Gjyqtarët për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë të përzgjidhen me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë

kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

3. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1(një).

4. Për çështjen me numrin rendor 2 në tabelë, propozohet që duke qenë se është çështje e ndarë nga i njëjti procedim penal me atë të çështjes nr. 75 akti, dhe kërkohet plotësimi i trupit gjykues për seancë paraprake, në pajtim me parashikimin K.Pr.Penale, përkatësisht nr.332/1 ku për përcaktohet se: “Kërkesat për dërgimin për gjykim të çështjeve të ndara nga i njëjti procedim penal, shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar” (në seancë paraprake), propozohet që të caktohet gjyqtari i caktuar më parë që ka shqyrtuar kërkesat e tjera për këtë procedim të lidhur me çështje të ndara në seancë paraprake, që ka qenë gjyqtari z. Paulin Çera, i cili është caktuar për gjykimin e kërkesës nr. 114.

Propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

1. Për 1 (një) çështje, për të cilën kërkohet respektivisht 1 gjyqtar, të përzgjidhet me short 1 i tillë, ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm që plotësojnë kriteret si më lart. Bashkëlidhur është edhe lista e gjyqtarëve që plotësojnë kriteret duke hequr nga lista gjyqtarët që kanë pengesë ligjore për t’iu nënshtruar shortit.

2. Për çështjen për të cilën vlejné parashikimet e ligjit procedural penal (neni 332/1 i K.Pr.Penale) të caktohet gjyqtari i përzgjedhur më parë nga Këshilli si gjyqtar i seancës paraprake, z. {...}.

Lidhur me përjashtimet nga shorti, në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti gjyqtarët që kanë pengesë ligjore, referuar relacionit më sipër.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime apo diskutime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale nr. 130, datë 18.12.2023, gjyqtare {...}.

Për çështjen e dytë, siç u propozua më sipër, nuk do të ketë short, për shkak se ka një përcaktim ligjor në nenin 332/1 i K.Pr.Penale ku gjyqtari i caktuar më parë në short nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për të shqyrtuar një kërkesë të mëparshme si gjyqtar i

seancës paraprake, dhe ai është z. {...}.

Ilir Rusi: Ka diskutime për sa u parashtrua së fundmi nga zoti Kurushi?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e propozimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Miratohet vendimi.

Me shqyrtimin e kësaj pike deklarohet e mbyllur mbledhja për shkak të shqyrtimit të të gjitha pikave të saj.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor